

LENA MANDA
DASHURI QË LAG SI SHI
ROMAN

BOTIMET TOENA

LENA MANDA

Dashuri
që lag si shi

ROMAN

Përktheu nga greqishtja
ALBINA GJINI PULLA

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2011

Titulli në origjinal: Λένα Μαντά, Ερωτας σαν βροχη

Botuese: Irena Toçi

Korrektore letrare: Jorida Sadikaj

Përkujdesja grafike: Albana Kuraj

Kopertina: Lavdie Cenmurati

ISBN 978 - 99943 - 1 - 752 - 3

© 2009 Psychogios Publications S.A.

© 2011 në shqip Botimet Toena

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: ++355 4 22 40 116; ++355 4 22 58 893

Fax: ++355 4 22 40 117

E-mail: toena@toena.com.al

redaksia@toena.com.al

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Pak fjalë prej meje...

Është hera e parë që po nis një parathënie, duke pasur kaq pak gjëra për të thënë. Pjesa më e madhe e tyre kanë të bëjnë me atë se si ndihem. Po mbani në duar një libër, me të cilin isha, jam dhe do të jem... e dashuruar plotësisht. Kur po e shkruaja, përjetova çaste shumë të bukura dhe kur më duhej ta ndërprisja, ndieja se më mungonte. Shumë net nuk mund të flija, kompjuteri më tërhiqte si magnet, personazhet më ftonin të plotësoja rrjedhën e jetës së tyre. Dhe unë shkruaja vazhdimisht...

As nuk e kuptova se si e mbarova, por atëherë erdhi dhe momenti më i vështirë.

Magjia e tij vazhdonte të më mbante akoma të lidhur me të. Kaloj vera dhe unë akoma isha në shoqërinë e Klelias sime, në rrugicat e Korfuzit, duke e shoqëruar në udhëtimet e shpirtit të saj, e joshur nga ëmbëlsia që më la njohja me të.

E di që do pyesni veten se si më lindi ideja për të shkruar këtë libër, cili ishte shkaku. Unë e them

gjithmonë, se kur shkruan për njerëz, duhet, para së gjithash, t'i dëgjosh dhe t'i kuptosh, të ndiesh dhimbjen e tyre dhe të pranosh zgjedhjet e tyre pa i dënuar nëse ato nuk ishin në lartësinë e pritshmërive të tua. Unë dëgjova dikur një Niqifor... një burrë që, megjithëse ishte i martuar, lejoi të hynte në jetën e tij një dashuri ilegale, një grua tjetër, dhe me vetëdije u tall me të. Dhe ju do më thoni: një histori e zakonshme. Por, ndërkohë, kjo histori më dha shtysën, ishte flaka që ndezi fitilin e frymëzimit. Këtë histori e bëra libër dhe hodha dritë jo mbi burrin që tradhtoi... por mbi atë, vajzën - personin e tretë që tradhtoi dhe u tradhtua shumë ashpër, që iu desh të paguante koston e veprimeve të veta për gabimet e kryera nga ajo vetë, duke shkatërruar jo vetëm jetën e saj, por dhe të atyre që e donin me të vërtetë.

Nuk e di se ç'emotione do të shkaktojë te ju libri im. Shpresoj dhe uroj që ta dashuroni njësoj si unë...

Libri i kushtohet... Niqiforit, të panjohurit prej jush Niqifor, i cili në perëndim të jetës së tij më besoi historinë e vet, së bashku me dhimbjen që ajo shkaktoi. Le të më falë që nuk shkrova për të, por për atë tjetrën... për Klelian e tij...

Lena Manda

Valët...

*L*uani i gurtë, që ndodhej në hyrje të portit të vogël po e priste ashtu si çdo ditë, dhe ajo e ktheu timonin e varkës në drejtim të tij. Tri ditë, zemërimi i detit nuk e kishte lënë që t'i afrohej, tri ditë kishte pritur me padurim që dallgët të ulnin tërbimin e tyre. I shihte dallgët se si u suleshin shkëmbinjve gjithë inat, megjithëse e dinin që do të shkërmoqeshin në cepat e tyre të mprehtë. Interesimi i tyre përqendrohej te këto brigje të thepisura dhe copëtimi i bregut ishte krijimtaria e vetme e tyre, ishte një vepër arti vetëm e tyre.

Ktheu kokën dhe vështroi shtëpinë e saj, së cilës po i langohej gjithnjë e më shumë. Ajo ndodhej në pjesën e mbyllur të portit, e mbushur me gjelbërim, e mënjanuar... ashtu siç ishte dhe ajo vetë. Portreti i burrit që qëndronte në breg ishte i njohur për të, dhe prandaj i buzëqeshi. Edhe që aty ku ishte mund të dallonte qartë ankthin e tij, që do të zgjaste deri në

çastin kur do ta ndihmonte për të lidhur varkën e saj, e pastaj do ta drejtonte për në kuzhinën e qetë, aty ku Evgjenia, gruaja e tij, do t'i përgatiste çokollatën e ngrohtë, të servirur si zakonisht në kupën e saj të preferuar, bashkë me një përkëdhelje të butë në flokë, ashtu si atëherë kur ishte fëmijë.

Evgjenia zbriti me mundim shkallët që të çonin për në det dhe shkeli në rërën e lagur, e cila ia lehtësoi paksa dhimbjen e këmbëve. “E marrtë e mira! U plaka më duket!” - mendoi dhe iu afrua burrit të saj. Ai akoma i kishte sytë të ngulur tek ajo varkë e vogël që çante detin me shpejtësi.

- Spiro, ç'po bën këtu? - e pyeti ajo, megjithëse e dinte përgjigjen.

- Iku... Prapë te luani po shkon..., - u përgjigj ai pa i larguar sytë nga deti.

- Epo, ka kaq ditë që është mbyllur brenda nga koha e keqe...Nuk e prisje që sot, me këtë kohë kaq të bukur, të ikte?

- Ç'është kjo që bën? A mund të më thuash, çfarë bën çdo ditë atje tej? Ka mësuar përmendësh çdo shkëmb të copëtuar, çdo lëkundje të detit, çdo shpellë...

- Përderisa gjithë verën Korfuzi mbushet me turistë, nuk e kupton që ajo vetëm në dimër e shijon? Nuk e sheh vajzën tonë se si vrenjitet në fytyrë sa herë sheh anijet turistike që i pushtojnë detin? Klelia vuan kur ishulli mbushet me njerëz... Lëre ta shijojë tani! Nuk është ftohtë dhe nuk fryn erë! Spiro, eja të shkojmë brenda, jashtë ka lagështirë dhe ne nuk jemi më të rinj...

E kapi për krahu dhe kur e kuptoi se i shoqi nuk po e ndiqte ushtroi më shumë forcë, derisa ai iu bind. Po i afrohej të shtatëdhjetave, edhe e shoqja gjithashtu...

Njëzet vjeç ishin që të dy kur u punësuan nga babai i Klelias, Rikardo Agapinos. Gruaja e tij, Luçia, ishte shtatzënë dhe u nevojitej ndihmë. Evgjenia dhe Spiro ishin të fejuar dhe menduan se duke filluar një punë të tillë do të mund të zgjidhnin problemet e tyre ekonomike, dhe kështu u vendosën në vilën luksoze të Agapinos, brenda në qytetin e Korfuzit, një shtëpi e stërmadhe, dritaret e së cilës shihnin nga gjiri i Garicës, nga ku të zotët e saj sa zgjoheshin shikonin detin. Personeli i shërbimit ishte sa një ushtri e tërë, por Evgjenia, të cilën zonja e shtëpisë e veçoi nga gjithë të tjerat, u vu menjëherë në shërbim të zonjës delikate. Ndërsa Spiro merrej me kopshtin, meqenëse lulet ishin dobësia e tij. U fliste, kujdesej për to dhe, pas pak kohe ndryshimi ishte i dukshëm. Trëndafilat treguan menjëherë mirënjohje për kopshtarin e ri dhe lulëzuan me gjallëri duke shpërndarë në atmosferë aromën e tyre dhe duke kënaqur kështu si të zotët e shtëpisë ashtu edhe mysafirët e tyre. Asnjëri nuk dinte se çfarë bënte Spiro në kopsht, por ndërkohë rezultatet ishin të jashtëzakonshme dhe i zoti i tij që në momentet e para i bëri Spiros një dhuratë të madhe.

Asnjëri nuk e priste që Luçia të ikte nga kjo botë duke lindur foshnjën e saj. E vetmja gjë që mundi të thoshte ishte emri i foshnjës, Klelia. Të gjithë u çuditën, përveç Evgjenisë. Vetëm ajo e dinte se sa e adhuronte zonja e saj shkrimtarin Ksenopulos dhe se romanin e tij *Dalje në sipërfaqe* ajo e mbante te koka e krevatit. E kishte mësuar përmendësh, por e lexonte dhe e rilexonte. Shpesh i thoshte edhe asaj që t'ia lexonte. Momentin kur personazhi i romanit, Pavllo, binte nga shkëmbi, në përpjekje për të shkullur lulet

e për t'ia hedhur ato Klelias, e cila kishte preferuar vëllain e tij, ishte pjesa e saj e preferuar, dhe zonja e ndjeshme qante sa herë që ajo ia lexonte. Kështu, emri që iu vu foshnjës ishte Klelia dhe asnjëri nuk guxoi të kundërshtonte porosinë e mamasë në prag të vdekjes.

Agapinos në momentin kur humbi gruan e tij, ndjeu t'i rrëshqiste toka nën këmbë. E dashuronte shumë, që kur kishte filluar të mbante mend veten e tij. Prindërit e tyre ishin miq dhe lidhja e tyre nuk çuditi askënd. Në qytet, të gjithëve u kishte rënë në sy dashuria e zjarrtë e djaloshit Rikardo. Zëra thoshin se ai nuk njohu asnjë grua tjetër para se ta bënte të vetën bukuroshen Luçie. Bile, shokët talleshin me të, pasi ai nuk i shoqëronte në dëfrimet e tyre të shfrenuara, por priste që të kalonin vitet e ta bënte të vetën gruan e jetës së tij. U largua nga Korfuzi pa dëshirën e tij, pasi i duhej të shkonte në Athinë, të studionte për avokati, për të vazhduar në këtë mënyrë traditën e familjes së tij, e më pas të merrte përsipër biznesin familjar, dhe u kthye në ishull pa vonesa të tepërta. U fejuan para se të hynte në radhët e ushtrisë dhe sapa u lirua, u martuan. Për vite të tëra lidhja e tyre nuk rezultoi me ndonjë trashëgimtar. Shëndeti i dobët i Luçies ndikoi që ajo të abortonte disa herë. Rikardo ia bëri të qartë se nuk donte fëmijë, në mënyrë që ajo të mos rrezikonte më, por Luçia përpiqej ta bindte që të provonin përsëri, derisa lindi Klelia... duke paguar nëna e vet me jetën e saj.

Klelia e shoi motorin e varkës dhe ngriti vështrimin lart. Vështrimi i saj ndeshi me vështrimin e luanit. Ai shkëmb, i cili prej një huqi të natyrës, kishte pamjen e prijësit të mbretërisë së kafshëve, sodiste detin

kryelartë, a thua se po priste diçka, a thua se bëhej fjalë për një çështje jetë e vdekje e ai duhej ta dallonte i pari. Pamja poshtë syve të tij ishte pak e zbehtë, por Klelia arrinte të dallonte gojën me dhëmbët e mprehtë e të zhveshur, që ishin të gatshme të përballonin rrezikun që do të vinte nga deti. Natyra ishte kujdesur edhe për krifën e tij të pasur, duke i ofruar shkurre të egra që mbështillnin kokën e gurtë.

E ktheu edhe ajo vështrimin drejt kaltërsisë përreth saj. Deti bashkohej me qiellin, dielli ishte i zbehtë dhe lindte hije të çuditshme, njëra nga të cilat ngjante si një sirenë që notonte poshtë sipërfaqes. Ajo uronte që përrallat e Evgjenisë të ishin të vërteta, që në thellësi të detit, të cilin ajo e donte aq shumë, të ekzistonin sirena. Sirenat, ato krijesa të kadifenjta që mbartnin në vete dijet e shekujve, që dinin për njerëzit gjithçka, megjithëse nuk kishin jetuar asnjëherë në mes tyre. Çfarë do t'i thoshin vallë në atë moment? Do ta akuzonin për gabimet e saj? Apo do ta ngushëllonin për atë se dashuria nuk iu dha si dhuratë por si mallkim?

Ndoshta do të mund t'i tregonin se, kur jeta e saj mori drejtimin e gabuar, kush ishte faji i saj dhe pse asnjëherë nuk ishte njësoj me shoqet e moshës së vet. Tani në moshën dyzetegjashtëvjeçare do të donte të dinte... Ndoshta kishte ardhur momenti të mësonte se si kishte arritur të shpërndante në thellësi të detit kaq shumë dashuri, kaq dhimbje, kaq sakrifica... Ndoshta ndonjë sirenë kishte hasur me të gjitha ato që ajo kishte hedhur në det dhe do të mund t'i jepte përgjigjet, të cilat ajo po i kërkonte prej kaq e kaq vitesh. A s'ishte izoluar për këtë arsye në këtë skaj të Korfuzit?

I hodhi përsëri një vështrim shtëpisë së saj. Edhe shtëpia i ngjasonte me një luan. Ashtu e ngulur si pykë mbi një shkëmb, e pakapërcyeshme, e padallueshme nga sytë kureshtarë, me detin para saj, ajo ngjante si një dritare drejt pafundësisë, asaj pafundësie që ajo aq shumë e adhuronte. Kishte momente që donte të bëhej njësh me të... momente që mendonte të merrte varkën e saj e të dilte në det të hapur, të zhytej në atë mister blu të errët që e tërhiqte si magnet. Nuk e bëri asnjëherë.

Evgjenia hodhi një vështrim nga dritarja dhe pa varkën e vogël që s'kishte lëvizur nga vendi. Për një grua të moshës së saj mund të mburrej se kishte shikimin e një fëmije. Klelia kishte ndaluar në vendin e saj të preferuar. Mund ta përfytyronte tek admironte e mahnitur luanin e Paleokastricës... atë shkëmb...

- Mund të më thuash, se çfarë po bën tani? - e pyeti Spiro duke ndjekur vështrimin e saj

- Po flet me sirenat! - iu përgjigj gruaja e tij.

- Ti e ke fajin! Ti dhe përrallat me të cilat i mbushje kokën kur ishte e vogël! - e akuzoi Spiro dhe piu me zhurmë një gllënjë nga kafja e tij.

- Kapu edhe me mua tani! Mallkuar qoftë ai! Mallkuar qoftë ora kur shkeli në këtë vend! Mallkuar qoftë edhe ora kur Klelia e takoi! Ajo, Klelia, vajza e vetme e Agapinos, të jetojë si eremite! - tha Evgjenia me ton të ashpër.

- Vallë ku të jetë...?

- Nuk dua t'ia përmendësh as emrin!

- Prit, moj grua, se nuk të pyeta për atë? Tjetër gjë më kaloi ndër mend... për tjetër krijesë e pyeta veten...

- Atë duhet ta harrosh fare-fare! Si të erdhi tani?
- Sa më shumë kalon koha, aq më shumë më kujtohet...
- I mjeri ti, më duket se u plake! Mos i kujto këto gjëra! Kurrë!
- Pse... ajo çfarë po bën? Pse kujton se po flet me sirenat si e çmendur? Pse u fsheh nga të gjithë, edhe nga vetë jeta?
- Spiro, kjo nuk është puna jonë!
- Nuk është puna jonë?! E ke fjalën për ne që e rritëm si fëmijën tonë që s'na dhuroi Zoti? E kë tjetër ka ajo? Edhe nëse Pavlo...
- Ç'të gjeti sot? Vetëm të kaluarën do kujtosh? Pavlo iku! Iku nga sytë këmbët!
- Dhe s'i jep të drejtë?
- Jo...

Vdekja e Luçies e ndryshoi brenda një nate jetën e Agapinos. Ai u mbyll në vetvete dhe në dhomat e errëta. Muajt u bënë vite dhe ai dilte nga shtëpia vetëm për të shkuar në zyrën e tij, derisa edhe këtë e bënte vetëm kur ishte e nevojshme. Vajzën e tij, që sa më shumë rritej aq më shumë i ngjante nënës së saj, e shihte rrallë. Sytë e saj, që kishin të njëjtën ngjyrë të rrallë si sytë e gruas së tij, gri të ndritshme e me reflekse jeshile gati të padukshme, i nguleshin si thikë në plagën e tij. Flokët e zinj të Luçies, që çmendej t'i shihte të lëshuara pranë tij, tashmë zbukurorin si kurorë edhe kokën e vajzës së tyre dhe ai nuk duronte dot të shihte shkëlqimin e tyre. I dukej sikur kjo kopje kishte thithur frymën e origjinalit, të atij origjinali pa të

cilin ai nuk mund të vazhdonte të jetonte. Ishte njësoj sikur t'ia kishte marrë atij frymëmarrjen.

Rikardo Agapinos po vyshkej. Kur ishte vetëm dyzet e pesë vjeç dukej si plak. I doli kurrizi, sytë humbën shkëlqimin e tyre, flokët iu zbardhën, buzët iu mblodhën, dhe miqtë iu larguan pa dëshirën e tyre. Ata u treguan të gatshëm për ta ndihmuar, por ai kundërshtoi. U trembën nga reagimi i tij në momentin kur i thanë të rimartohej, që vajza e tij të kishte një nënë. U bë si bishë dhe i përzuri nga shtëpia me të keq. Nuk pranoi të shihte më asnjërin prej tyre, mendonte se ata fyen kujtimin e saj. Një natë shkuli me duart e tij të gjithë trëndafilat. Me ato duar të gjakosura i tmerroi Spiron dhe Evgjeninë, të cilët u kujdesën për t'ia mjekuar. Ata ishin të vetmit që guxonin t'i afroreshin, dhe veçanërisht Evgjenia, e cila kishte qenë njeriu më i dashur për Luçien. Në duart e saj fjeti atë natë, pasi qau si fëmijë në prehrin e saj. Në të vetmin prehër që njohu edhe Klelia. Përkëdheljet e Evgjenisë, ato kishte vogëlushja në vend të përkëdheljeve të mamasë së saj. Në duart e saj u rrit, ajo dëgjoi belbëzimet e para dhe fjalët e ngatërruara, asaj i rrihte zemra kur hodhi hapat e parë, dhe ishte po kjo grua besnike që kur ishte e sëmurë i rrinte te koka derisa t'i binte temperatura. Nën hijen e saj shkelte gjatë gjithë viteve...

Klelia e kuptoi menjëherë ndryshimin e motit. Sytë e saj, kur ndeshën me retë ngjyrë plumbi, thjesht

vetëm sa ia vërtetuan këtë gjë. Pas disa minutash do të fillonte furtuna. Deti ishte errësuar dhe hija e sirenës humbi. Sikur ta kishte kuptuar edhe ajo që po fillonte furtuna dhe u nxitua të gjendej në qetësinë e thellësisë. Filluan dallgë të vogla e të shkumëzuara dhe varka filloi të lëkundet. Me duar të sigurta ajo ndezi motorin dhe ktheu timonin për nga toka. E dinte se Spiro do të ishte në breg të detit duke e pritur. Derisa të mbërrinte ajo, mund të fillonte stuhia dhe do lagej i shkreti. Pikat e para e lagën kur po shkelte në pjesën prej çimentoje të molit të vogël.

- Mirë që arrite në kohë, zonjë! - i tha i moshuari dhe me vështrimin e tij e qortoi me të butë, ndërkohë që duart e stërvitura po siguronin varkën e vogël.

Në vend të përgjigjes së Klelias, u dëgjua një bubullimë. U larguan duke vrapuar dhe u futën në shtëpi. Evgjenia u afrua menjëherë.

- Ah, ç'të bëj me ju të dy! - ngriti zërin. - Do merrni ndonjë të ftohtë! Zonja ime, shko shpejt ndërrohu që të mos ftohesh! Edhe ti plak i çmendur... Se pastaj do më duhet të të fërkoj prapë me vajguri!

- Hë moj grua, edhe ti me sherret e tua! As tri pika nuk na ranë!

Nuk arriti të mbaronte fjalën dhe një bubullimë e fortë tundi shtëpinë.

Evgjenia lutej duke bërë kryqin. "Perëndia vëntë dorën e saj! Sot do përmbysët dynjaja!" - pëshpëriste.

Klelia shkëmbeu me Spiron një shikim konspirativ, ashtu si atëherë kur ishte e vogël, dhe iku me vrap në dhomë që të ndërrohej, se nëse nuk e bënte, Evgjenia mund ta ndiqte pas e ta vishte vetë, sikur ajo të ishte pesë vjeç...

Kur erdhi koha që Klelia të shkonte në shkollë, Spiro me Evgjeninë u veshën me rrobat më të mira dhe e shoqëruan. Spiro ishte ai që ia mbajti librat për herë të parë, kur po ktheheshin në drekë të dy së bashku. Të gjithë u habitën se si Agapinos, që ishte aq i pasur e dërgoi vajzën e tij në një shkollë publike dhe nuk menduan se kjo ishte rezultat i indiferentizmit të tij total. Sa herë ishte përpjekur Evgjenia t'i fliste, ta bënte të interesohej e të merrte një vendim për shkollën e vajzës së tij, por ai e dëgjonte me shikim të zbrazët dhe pastaj largohej pa dhënë asnjë përgjigje. Atëherë Spiro mori iniciativën dhe e regjistroi te shkolla më e afërt.

- Po si të marrim ne një përgjegjësi të tillë? - e kishte pyetur veten Evgjenia.

- Po s'kemi kohë as të mendohe mi! - i ishte përgjigjur i shoqi. - Zotëria kështu si e ka nisur do ta lërë fare pa shkollë vajzën e tij. Kur bëhet fjalë për vajzën e tij, as nuk flet e as nuk dëgjon. Prit njëherë, të shkojë vajza më mirë në klasë të parë, e pastaj shohim e bëjmë.

Dhe kështu Klelia u regjistrua në shkollën publike më të afërt si të ishte fëmija i Spiros dhe Evgjenisë nga Kinopiasti, një fshat afër Gasturit, dhe jo si vajza e Rikardo Agapinos nga Korfuzi, me origjinë fisnike dhe pasuri përrallore...

Klelia u mbështoll me rrobëdëshambrin e saj të ngrohtë dhe u afrua te dritarja. Stuhia kishte shpërthyer me furi. Shiu rrihte detin si me kamxhik dhe shkrepitmat çanin qiellin. Dallgët, ashtu si

godisnin me forcë shkëmbinjtë, po njësoj marshonin edhe drejt bregut. Dielli s'dukej gjëkund. Ajo teshtiu fort në të njëjtin moment kur një rrufe i bëri edhe dritaret të gjëmonin po aq fort. Kryqëzoi duart në gjoks dhe në të njëjtën kohë u ndërgegjësua se sa të zbrazëta ishin gjithmonë ato duar. Për vite të tëra këto duar ishin të zbrazëta. Të zbrazëta nga dashuria, të zbrazëta nga një fëmijë... Gjithmonë nuk i mbetej asgjë, edhe atëherë kur mendonte se e kishte të gjithë botën të sajën...

Ia kishte thënë dikur atij dhe ai i kishte buzëqeshur, ashtu siç bënte gjithmonë kur donte të ndërronte temë, pak para se ta puthte, duke ditur se ishte e vetmja mënyrë që të harronte të gjitha ankesat e saj, gjithë pyetjet që i digjnin trurin. Kishte kaluar një jetë që atëherë, por plaga dhembte akoma, mbetej e hapur. Gabimet e saj që krahasoheshin me shkëmbinjtë e lartë, i copëtonin shpirtin. Koha nuk kishte sjellë harresën. Përkundrazi. Mbartte me vete dhimbjen, se tashmë koha kishte ikur, ishte rrokullisur në mënyrë të pakthyeshme, nuk ekzistonte asnjë mundësi që ta ndryshonte, ta korigjonte... Borxhe nga e kaluara... I mbartte me vete... Ç'rëndësi kishte nëse u largua, nëse u varros në një skaj të asaj toke që aq shumë e donte...! Jeta e saj ngjante me letra të grisura që i fshihte në xhepin e saj...

Mbështeti ballin e saj në xham, duke u përpjekur që të largonte prej andej rrudhat e kohës dhe të dhimbjes. Kontakti me xhamin e ftohtë e solli në vete. Evgjenia do të ishte duke e pritur në kuzhinë, dhe natyrisht do të ishte shqetësuar. Gjithmonë shqetësohej për të. Që atëherë kur Klelia kishte

filluar të mbante mend veten e saj, nga sytë e Evgjenisë buronte dashuri por edhe shqetësim.

Viti i parë i shkollës ishte si një zbulim për Klelian e vogël. Mbi të gjitha zuri shumë shokë e shoqe dhe kjo e bënte të lumtur. Deri atëherë mund të kishte pasur gjithnjë pranë Evgjeninë dhe Spiron, që i plotësonin të gjitha dëshirat, por ishte ndryshe të kishe shokë, të cilët mund të vraponin me orë të tëra pa u lodhur, të cilët s'kishin frikë se do i bëhej pis apo do i grisej përparësja dhe që bënë të njëjtat çapkënlleqe si të sajat, ndoshta dhe më shumë.

Evgjenia mërzitej me të. Megjithëse merrej shumë me të duke i krehur flokët e saj të gjatë, ose duke zgjedhur fjongot më të bukura për gërshetat e saj, ajo kthehej gjithmonë pa to dhe me përparësen aq të zhubrosur, sa Evgjenisë i duhej shumë kohë për ta pastruar e hekurosur në mënyrë që ajo të shkonte ditën tjetër në shkollë ashtu si duhej të shkonte një vajzë e sërës së saj. Por vajzës nuk i bënë fare përshtypje këto gjëra. Ajo luante gjithë qejf në orën e pushimit, por kur fillonte mësimi, atëherë ndryshonte gjithçka. Kjo vajzë çapkëne ngulte sytë te mësuesja dhe nuk i hiqte prej andej derisa binte zilja. Si sfungjer i thithte dijet dhe pyetjet që bënte ishin të çuditshme për një fëmijë të moshës së saj.

Shumë shpejt filloi t'i lutej Evgjenisë që të shkonte te shtëpia e ndonjërës prej shoqeve që të luanin dhe me ndrojtje kërkoi leje që të sillte dhe ajo shoqe në shtëpinë e saj. Por kjo nuk mund të bëhej pa lejen e

babait, kështu Evgjenia u gjend para tij duke lëvizur duart mekanikisht.

- Evgjeni, çfarë do? - e pyeti me mundim Rikardo.

- Zotëri, e kam fjalën për vajzën..., - filloi të fliste me frikë ajo. - Për Klelian tonë...

- Çfarë? Të kam thënë të mos ma trullosësh kokën!

Bëj ç'të duash me të!

- Por zotëri, vajza tani shkon në shkollë dhe...

- Dhe çfarë, të duhen para?

- Jo, jo... Por tani ka shoqe dhe dëshiron që të vij në këtu e të luajnë së bashku!

- Ku, këtu? Në shtëpinë time? - Agapinos e pa i inatosur.

Po të kishte qenë për veten e saj, Evgjenia do kishte ikur me vrap, me atë shikim të tijin, por ishte fjala për vogëlushen dhe nuk...

- Zotëri, por shtëpia është dhe e saj. Vajza është shumë e vetmuar, nuk bën...Nuk të vjen keq...? Pastaj, edhe zonja nuk do të donte një jetë të tillë për vajzën e vetme! - fjalët e fundit i tha duke iu marrë fryma.

- Gruan time nuk dua ta ngatërrosh me këto gjëra!

- bërtiti Agapinos, ashtu siç priste edhe ajo që të ndodhte.

- Gruaja juaj, zotëri... por dhe mamaja e Klelias sonë... Pastaj, s'po të kërkoj ndonjë gjë të madhe...

- Do më sjellë qurravecë që do vrapojnë e do bërtasin këtu brenda? Dua qetësinë time!

- Të lutem... Bëje për mua! Kurrë nuk të kam kërkuar ndonjë nder që kur kam ardhur të punoj këtu. Pastaj ti rri gjithë kohën mbyllur. Unë do t'i mbaj fëmijët larg nga dera dhe nga dritaret e tua. As nuk

do e kuptosh që do të jenë këtu, të betohem! Mos më thuaj jo, zotëri...

I hodhi asaj një vështrim të rreptë dhe pastaj u mbështet në dritare duke parë nga kopshti. Atje ishte Spiro bashkë me Klelian, duke u kujdesur për lulet. Agapinos po vështronte të bijën, e cila ishte e gjatë dhe e dobët, gjithë vëmendja e saj ishte përqendruar te lëvizjet e kopshtarit, duke u përpjekur ta imitonte atë. Para syve iu shfaq përsëri pamja e gruas së tij. Ajo i donte shumë lulet, saqë disa herë i bënte duart pis me dhë, dhe atëherë Spiro e qortonte me të butë, duke i thënë se një zonjë e pasur nuk duhej të merrej me këto gjëra. Luçia qeshte e gëzuar dhe i përgjigjej se përderisa lulet e saj të preferuara mbinin në dhë atëherë s'kishte asgjë të keqe nëse ajo i bënte duart pis me dhë.

- Atëherë, zotëri? - e ndërpreu Evgjenia nga ëndërrimet.

- Le të vijnë... Por ki kujdes, Evgjeni! Po dëgjova zhurma, do t'i përzë nga shtëpia menjëherë! - i tha ai me ton të rreptë. - Dhe tani më lër në qetësinë time!

Nga gëzimi i erdhi t'i puthte dorën, por nuk e bëri. Që nga ajo mbrëmje kur kishte qarë në prehrin e saj, asnjëherë nuk la njeri që ta prekte. Dhe Evgjenia ndiente keqardhje, por më shumë donte vajzën e saj... Klelian e saj...

Klelia zbriti në kuzhinë, por aroma e çokollatës së ngrohtë e kishte bërë për vete që te shkallët.

- Erdhe zonja ime? - i uroi mirëseardhjen Evgjenia duke buzëqeshur. - Ku do ta pish çokollatën, shpirti im?

- Këtu... bashkë me ju...

Klelias i pëlqente shumë kuzhina e bollshme, plot dritë, me perdet me ngjyra të gëzueshme dhe dritaret e mëdha. Gjysma e tyre shihte nga kopshti i sistemuar bukur dhe gjysma tjetër shihte nga deti. Përreth kishte shumë vazo të mbjella me erëza që Evgjenia i përdorte për gatimet e saj të shijshme. Ishte mbretëria e saj, aty ku ajo kalonte pjesën më të madhe të ditës, dhe Klelia kur kishte arëduar shtëpinë, ishte munduar që kuzhina të ishte e përsosur, me të gjitha pajisjet që nevojiteshin, që të mos lodhej engjëlli i saj mbrojtës. Ankesa e vetme e Evgjenisë ishte se asnjëherë nuk ftonin miq në shtëpi që të gatonte për shumë vetë dhe se Klelia hante gjithmonë pak. Mendohej me të gjitha mënyrat ta bindte që të hante pak më shumë por në përgjithësi ajo përfundonte tek ëmbëlsirat që ishin dobësia e saj qëkur ishte fëmijë.

Ditën e parë që i erdhën shoqet në shtëpi, Klelia ishte e nervozuar. Kur Evgjenia po e krihte ajo hidhej e përdridhej dhe gërshetat nuk iu bënë shumë të drejta, por s'kishte ç't'i bënte. Pesë vajzat, të cilat arritën pak me vonesë, në fillim ngrinë kur panë vilën madhështore. Mamatë e tyre që i shoqëronin nguruan të kalonin derën e murit rrethues të vilës së Agapinosit.

Sigurisht që e dinin se shoqja e vajzave të tyre ishte e pasur, por kur ndeshën për herë të parë vilën, atë vilë madhështore, menduan të ktheheshin mbrapsht. Dhe do ta kishin bërë, nëse nuk do të rendte Evgjenia me nxitim t'u hapte derën dhe t'u uronte vajzave mirëseardhjen.

Dhoma e Klelias ishte si dhomë princeshe. Luçia ishte e sigurt që do të lindte vajzë dhe e kishte kompletuar atë siç duhej. Rikardo e ngacmonte, duke i thënë se në qoftë se fëmija ishte djalë, duhej ta kompletonte përsëri nga fillimi, por ajo si lozonjare i tërhiqte veshin dhe i thoshte se nuk duhej t'i kundërvihej instinktit të saj femëror. Si një pallat e bëri dhomën, pa e ditur se vajza e saj do të rritej e vetme aty brenda. Vajzat ngelën me gojë e sy hapur kur para tyre u shfaq pamja e dhomës si në parajsë, mbushur me lodra, të cilat ishin blerë të gjitha në Itali dhe në Francë. Kishte kukulla që ngjanin si të vërteta, me flokë të gjatë e të krehur bukur, me sytë që i hapnin dhe i mbyllnin, jo të pikturuar, dhe me veshje prej mëndafshi, gjithashtu në një kënd ishte një tavolinë e mbushur me complete çaji prej porcelani, dhe më tutje ishin radhitur tenxhere prej metali sikur të ishin edhe ato të vërteta.

Përfundimisht, Evgjenisë nuk iu desh të bënte asgjë që vajzat të mbanin qetësi që të mos shqetësohej Agapinosi. Asnjëra s'kishte dëshirë të dilte nga parajsa. Luajtën në qetësi disa orë, dhe vetëm kur zbulonin ndonjë lojë të re, që ngjante në sytë e tyre si një mrekulli e vogël, lëshonin thirrje admirimi, të cilat ishte e pamundur të përshkonin muret e trashë dhe të arrinin deri në bibliotekë, aty ku ishte ngujuar i zoti i shtëpisë.

Evgjenia shihte dhe nuk ngopej duke parë fytyrën e gëzuar të Klelias, kur ndante lodrat e saj me shoqet, dhe kuptoi se tashmë ajo i shihte lodrat edhe me një mënyrë tjetër, përmes admirimit të fëmijëve. Për të, të gjitha këto ishin diçka e zakonshme, që nuk fshihnin asgjë të re.

Por duke vënë re shprehjet e fytyrës së fëmijëve të tjerë dhe duke e krahasuar shtëpinë e saj me shtëpitë e tyre, të cilat i kishte vizituar, ndoshta për herë të parë filloi të kuptojë dallimin midis klasave shoqërore.

Gjithsesi, vajzat shumë shpejt pranuan ndryshimin që kishin me shoqen e tyre dhe arritën ta donin për atë që ajo ishte në të vërtetë dhe jo për shtëpinë e bukur dhe dhomën e magjishme. Megjithëse në fillim Evgjenia u tremb, në vazhdim vuri re se nuk kërkonin vetëm ato të vinin në shtëpinë përrallore, por e ftonin dhe Klelian të shkonte në shtëpitë e tyre, ashtu siç ndodhte edhe më parë. Në pranverë shkëmbimi i vizitave u ndërpre. Koha u ngroh, shëtitjet në Spianadhë dhe rendjet në fushën e kriketit ishin më dëfryese. Evgjenia me Spiron pinin kafe në Liston dhe Klelia shijonte diellin dhe lojërat me bashkëmoshataret e saj. Sa më shumë rritej, aq më shumë ngjante me zonjën, por vetëm nga pamja e jashtme. Fatmirësisht nuk kishte trashëguar shëndetin e saj delikat. Nuk sëmurej kurrë, faqet i kishte të kuqe si molla, dhe temperatura i ngrihej shumë rrallë. Ishte e bukur dhe e shëndetshme, dhe çifti krenohej me të si të ishte fëmija i tyre. Pse s'ishte? Kishin gati gjashtë vjet që ishin martuar, u martuan pak para se të vdiste Luçia, dhe megjithëse që të dy ishin vetëm njëzetegjashtë vjeç, Evgjenia, kishte filluar të mësohej me idenë që mund të mos bëhej kurrë nënë. Por asnjëri prej tyre nuk diskutonte për këtë gjë. Dalëngadalë, pa e kuptuar as ata vetë, Klelia zuri vendin e kësaj fëmije.

Mëngjesi tjetër në molin e vogël ishte i qetë. Deti, pothuajse i penduar për mënyrën se si ishte sjellë një ditë më parë, përkëdhelte ëmbël rërën me servilizëm, deri diku në mënyrë lozonjare, ashtu si fëmija që e di që ka bërë çapkënlëqe dhe me mënyrat e tij përpiqet të fitojë përsëri përkujdesjen e të rriturve. Varka e bardhë, e lidhur në molin e vogël, tundej vazhdimisht.

Klelia vajti pranë saj dhe e përkëdheli. “Durove dhe këtë radhë moj plakushja ime...”, - i tha me butësi dhe varka u përkund nga vala sikur po i bënte shenjë në mënyrë pohuese.

U largua. Për herë të parë nuk kishte dëshirë të udhëtonte nëpër valë bashkë me të. Deti i erdhi te këmbët dhe ndjenja e akullit e puthjes së tij e rrëqethi, por nuk u tërhoq. Eci edhe pak, derisa uji i arriti deri te pulpat, dhe nga i ftohti filloi të ndiente një mpirje të ëmbël. Ktheu sytë nga qielli. Dielli prapë s’kishte dalë. Përpiquej të tregonte se ishte i pranishëm duke lëshuar një dritë të zbehtë e të sëmure, e cila nuk mjaftonte për të ngrohur atmosferën. Kishte hyrë nëntori dhe me sa dukej dimri këtë vit do të ishte i ashpër.

- Klelia! Zonja ime!

Zëri i Evgjenisë e bëri të kthente kokën prapa. Me gjysmën e trupit të varur jashtë dritares ajo po e thërriste gjithë frikë.

- Evgjeni, ç’pate? - iu kthye Klelia, megjithëse e dinte përgjigjen.

- Zonja ime, u budallallepse? Çfarë bën brenda në det në këtë kohë? Ngjitu lart me vrap! Do ftohesh!

Klelia e dinte se do ishte e kotë ta kundërshtonte. Ajo ishte gati të vinte e ta merrte me zor, megjithëse e dinte se sa shumë e lodhnin shkallët që të zbrisnin

nga shtëpia për në det. Evgjenia nuk e duronte dot detin, nuk kishte hyrë kurrë në det dhe nuk e kuptonte këtë dashuri të çuditshme të zonjës së saj për të. Spiro gjithmonë e ngacmonte, se si kishte mundësi që megjithëse kishte lindur e ishte rritur në ishull, nuk donte as ta shihte detin. I thoshte se duhet të kishte lindur në mal përderisa nuk donte as ta shihte, por Evgjenisë nuk i ndryshonte mendja. Herën e parë dhe të fundit që kishte provuar të hynte në det, gati ishte mbytur. Që atëherë nuk iu afrua më.

Klelia ndryshoi drejtim dhe u kthye menjëherë në shtëpi.

Çifti po e priste, ndërkohe Evgjenia me duart në mes ishte gati për sherr.

- Zonja ime, ç'janë këto bëma? - filloi sa e pa. - Nuk të mjaftoi vera? Ç'bëje në det në këtë kohë?

- Sa laga pak këmbët, Evgjeni, nuk notova!

- Dhe atë kishim mangët. E pastaj të marrësh ndonjë të ftohtë e mos di ç'të të bëj!

- Mirë, mirë, mos bërtit! Nuk do ta përsëris! Por, e dashur Evgjeni, mos ndoshta duhet ta kuptosh se unë jam rritur? Po shkoj pesëdhjetë vjeç dhe ti më trajton sikur të jem dhjetë vjeç!

- Mos bëj lojëra fëmijësh që të të quaj të madhe! Dhe nuk je pesëdhjetë vjeç akoma! Sapo mbushe dyzetegjashhtë!

Evgjenia fliste e ajo vuri re se të dy kishin veshur rrobat e tyre më të mira.

- Evgjeni, nuk më thua, pse jeni veshur të dy sikur po shkoni në mbrëmje?

- Po ja... shpirti im... E diel sot, - iu përgjigj Spiro.

- Edhe? Do shkoni në kishë? Si ju erdhi?

- Po sot nuk është një e diel e zakonshme. Sot është 1 Nëntor!

- A, po... kuptova...

Nuk kishte asnjë banor të Korfuzit që mos ta dinte se ç'ditë ishte dita e sotme. Në qytet bëhej një litani e madhe për nder të Shën Spiridhonit, i cili në vitin 1673 i kishte shpëtuar banorët e ishullit nga epidemia e murtajës. Ndjeu një të therur në gjoks, por kjo e therur nuk kishte lidhje me shëndetin, por me kujtimet e saj. Njëzet e një vjet kishin kaluar që nga hera e parë që e kishte parë atë. Ishte vetëm shtatëmbëdhjetë vjeç, duke ndjekur bashkë me shoqet e saj ceremoninë e festës së litanisë. Dhe ai... ai sapo kishte ardhur në Korfuz që të fillonte punë si avokat. Një si hije iu duk sikur i kaloi para duke ia fshehur siluetën e pamjes së tij. Apo mos ndoshta sytë e saj ishin mbushur me lot? Jo... Kishte vite që nuk qante për të. Kishte vite që s'i kujtonte dot as fytyrën. A thua se kujtesa e saj e mbronte. Kishte zgjedhur këtë mënyrë për ta mbajtur sa më larg dhimbjen e saj.

Dora e Evgjenisë në sup e solli në vete.

- Çfarë ke shpirti im? Nuk je mirë? Spiro, merr doktorin!

Paniku në zërin e saj e bëri Klelian të vinte buzën në gaz.

- Si bën edhe ti! Shumë mirë jam! U hutova pak, kjo është tjetër gjë. Pra do të shkoni në qytet?

- Po... Domethënë në qoftë se na lejon..., - pëshpëriti Spiro.

- Spiro, ç'janë këto fjalë? - e kritikoi ajo. - Kush jam unë që mund t'ju pengoj të shkoni ku të doni? Kur ju

trajtova unë si shërbëtorët e mi, dhe jo si të afërmit e mi? Thjesht po thosha... mendova, ndoshta është momenti... Dua të them... të vij dhe unë!

Dy të moshuarit shqyen sytë dhe u tronditën sikur t'u kishte rënë rrufeja në kokë.

- Ç' patët? - i pyeti ajo. - Gjë e keqe është që dua të vij në qytet?

- Kishe më shumë se njëzet vjet pa e bërë këtë, zonja ime! - thirri Evgjenia.

- E pastaj? Tani erdhi çasti për ta bërë! Dua të shoh përsëri vendin ku u rrita... ku... Nejsë! Po shkoj të vishem! - tha dhe u zhduk.

Evgjenia i ra tavolinës me grusht.

- Kjo gjë s'më pëlqen fare! - komentoi papritur.

- Pse moj grua? Ti ke kaq kohë që ankoresh se është izoluar, se nuk takon asnjëri, se po i ngjan të ndjerit Rikardo. Mund t'i bëjë mirë të vijë.

- Çfarë?! Të përjetojë përsëri të gjitha ato? Këto gjëra s'janë për mirë. Dhe pastaj... ia kam frikën edhe... takimeve të padëshirueshme.

- Çfarë takimesh, Evgjeni? Në qytet nuk ka mbetur më asnjëri që i përket të kaluarës. Sa herë kemi vajtur, ke parë ndonjë të njohur ti? Kanë ikur të gjithë... janë shpërndarë... miq dhe armiq...Tani në verë, qyteti është i mbushur me turistë. Gjen njerëz nga të gjitha racat e botës!

- Në verë! Tani është vjeshtë dhe për pak hyn dimri. Ah Spiro, kam frikë! Nuk kam frikë vetëm të gjallët... Kujtimet, ato më bëjnë të dridhem...

- Ato kujtime, zemra ime, e ndjekin edhe këtu.

Pak para se Evgjenia të deziluzionohej për sjelljen e vajzës së vetme të Agapinosit, Klelia zbuloi se i pëlqente të lexonte. Kishte mbaruar klasën e tretë fillore, rezultatet në mësimet përmirësoheshin nga viti në vit, por gjithashtu ajo sa vinte e bëhej më e shkathët. Dhe papritur, Klelia zbuloi bibliotekën...

Agapinosit gati sa s'i ra infarkt, kur një të diel, dera e bibliotekës u hap me forcë, dhe u shfaq Klelia. Ajo e vështroi pa frikë. Babai ishte për të një nocion paksa i papërcaktuar, një hije që e shihte netëve kur kalonte për të shkuar në dhomën e tij. Zëri i tij nuk ekzistonte në kujtesën e saj, e dëgjonte rrallë, kryesisht kur fliste me shërbëtorët. Asaj nuk i drejtohej kurrë. Pra, pa ditur asgjë për rrezikun, kaloi pragun. I hodhi një shikim pa interes dhe i nguli sytë me admirim të vëllimet e librave që mbushnin muret nga njëri cep i dhomës në tjetrin.

- Ua, sa shumë libra! - bërtiti dhe më në fund vendosi ta shikonte. - I keni lexuar të gjitha këto? - e pyeti.

Agapinosi u gëlltit. Pothuajse kishte frikë nga ajo krijesë e gjatë dhe e hollë që ishte një kopje besnike e Luçies. Kur sytë e saj u ngulën te sytë e tij, frymëmarrja e tij u ndal. Ishte ajo që po e shihte, vetëm se në thellësi të tyre nuk ekzistonte dashuria e syve të saj.

- Pjesën më të madhe..., - iu përgjigj ai me mundim.

- Kështu shpjegohet..., - komentoi e menduar Klelia.

- Prandaj nuk dilni kurrë prej këtej... Natyrisht duhet shumë kohë për të lexuar të gjitha këto! Vërtet, duhet t'i lexoni të gjitha? - vazhdoi Klelia, duke prekur me shumë respekt vëllimet me kapak prej lëkure.

- Ç'do të thuash? - Agapinosi e kishte humbur fare.

- Them se edhe mua më thotë mësuesja të lexoj shumë libra dhe duhet t'i kem lexuar deri në fund të vitit! Por librat që duhet të lexoni ju janë të panumërta! Duhet t'i lexoni patjetër të gjitha, dhe nëse po, deri kur? - tha dhe pa pritur përgjigjen e tij, tërhoqi një libër dhe e hapi. Po sa filloi ta lexonte, fytyra e saj u nxi dhe e pa e zhgënjyer.

Frymëmarrja iu ndërpre përsëri. Sytë e saj ishin mbushur me të njëjtat reflekse jeshile që i mbusheshin dhe Luçies kur diçka e shqetësonte.

- S'ka asnjë figurë dhe nuk kuptoj se çfarë thotë! - tha Klelia.

- Nuk janë për ty këto libra! - u përgjigj Agapinosi, duke u përpjekur të rifitojë tonin e tij të rreptë.

- Sa keq! Sa do të doja të gjeja diçka për ta lexuar! Mendova se një bibliotekë do të kishte shumë libra dhe prandaj erdha, por bëra gabim... Ndoshta duhet të provoj lart...

- Lart është biblioteka e saj... e mamasë tënde! - ngurroi ta thoshte, por Klelia nuk e kuptoi.

- E di! - u përgjigj. - Është ngjitur me dhomën e saj! Shkoj shpesh atje!

- Ku? Në dhomën e saj?!

- Po... Më pëlqen t'u mbaj erë fustaneve... Kanë akoma aromën... Mamaja ime ishte shumë e bukur!

- E nga e di ti?

Vajza qeshi me të madhe dhe jehona e të qeshurës së saj e trembi më shumë se ato që dëgjoji.

- Je pak shakaxhi! Përderisa kam gjithë fotografitë e saj! Tre albume! Njëri është me foto të dasmës suaj! Shkëlqenit që të dy! Ato më pëlqejnë më shumë nga gjithë të tjerat! Dhe në ato fotografi ju buzëqeshni!

- Ku i gjete?

- M'i ka dhënë Evgjenia. Ajo më flet për mamanë time. Iku nga kjo jetë kur linda unë... a s'është për të ardhur keq? S'priste dot të njiheshim njëherë? Por përderisa e donte Zoti, ndoshta s'mundej... Ashtu si Evgjenia, që vrapon menjëherë sa e thërrisni ju. Veçse ajo pas pak kthehet përsëri. Me sa duket mamaja ka më shumë punë atje, pranë Zotit!

Agapinosi vuri duart në kokë, i dukej sikur po i digjej. Një realitet, të cilin e injoronte qëllimisht për nëntë vjet me radhë, kishte penetruar tashmë në botën e tij dhe e kishte bërë copash vetëm me disa biseda, të thëna prej vajzës, nënën e së cilës ai adhuronte. Vetëm në atë moment e kuptoi se ç'kishte bërë, për çfarë krimi ishte fajtor dhe përgjegjës. Luçia iu shfaq para syve si e gjallë, si asnjëherë më parë, dhe sytë e saj ishin plot qortim e zemërim. Si ishte sjellë kështu me fëmijën për të cilën ajo sakrifikoi jetën e saj për ta sjellë në këtë botë? Kush ishte ai, që vendosi të marrë hak për vdekjen e saj, kundër krijesës së vetme që nuk kishte asnjë faj?

Pa e kuptuar as vetë se si, iu afrua vajzës së vogël e cila po e shihte me interes. Bëri të prekte faqen e saj, kur në atë moment hyri Evgjenia e llahtaritur.

Sa e pa, e keqkuptoi skenën.

- Mos, zotëri! Mos i bëj keq vajzës! Nuk ka faj për asgjë! Unë u harrova dhe nuk e vura re! Nuk do të të shqetësojë përsëri! Për Shën Spiridhon, nuk do shkelë më këtu!

- Evgjeni, çfarë po thua? U çmende? Pse t'i bëj keq? - pyeti i habitur Agapinosi. Doja ta përkëdhelja!

Evgjenia shqeu sytë sikur po shihte para saj një të çmendur.

- Po, zotëri... Si thoni ju..., - pëshpëriti dhe iu afrua vajzës. - Ta marr tani, se më duhet?

- Po...

Evgjenia, me lëvizje të ngadalta dhe pa i hequr sytë nga i zoti, e përqafoi Klelian dhe e tërhoqi për nga dalja. Atje e ndali zëri i tij.

- Vogëlushe... dua të them... Klelia... merr sa libra të duash nga... biblioteka tjetër! Por t'i mbash me shumë kujdes... Ashtu siç i mbante ajo!

- Faleminderit, por do e bëja dhe po të mos ma thoshe! Librat e tua nuk lexohen! - iu përgjigj vajza e vogël duke buzëqeshur dhe u zhduk, para se ta shihte babanë e saj të binte i shokuar në karrigen e tij dhe të mbante kokën me duar.

Edhe në këtë pozicion që gjendej munda të ndiente sytë e gruas së tij ta gozhdonin që nga fotografia që mbante gjithmonë mbi tryezën e tij të punës.

Makina e vjetër, si gjithmonë kishte vështirësi për t'u ndezur, por më në fund ia arriti. Klelia e përdorte rrallë, asaj nuk i pëlqente t'i jepte makinës dhe nuk dilte pothuajse asnjëherë nga shtëpia. Dhe ndonjëherë që ndodhte kjo gjë, e kishte bërë zakon të shkonte me varkën e saj deri në portin e Paleokastricës, atje ku në verë ankoroheshin anijet turistike, dhe që andej për lëvizje brenda qytetit, përdorte autobusin. Por dhe kjo ndodhte kur ishte e domosdoshme. Deri në Guvia e në Kontokali kishte vajtur, por në qytet asnjëherë...

Tani, e ulur në ndenjësen e pasme, e kishte ngulur vështrimin e saj në vendet ku po kalonin dhe nuk po merrte fare pjesë në bisedën që po bënte çifti. Sa hynë

në qytet, Evgjenia e kuptoi që ajo lëvizi nga vendi, dhe nuk duhej stetoskop që të kuptonte se zemra e saj i kishte shtuar rrahjet. Spiro u kthye djathtas për nga kalaja venedikase dhe sapo e kaloi, përfundoi në Theotokë, në qytetin e ri, aty ku ishin ngritur me dhjetëra qendra tregtare. Pastaj mori për nga Desila e cila të çonte në rrugën Akademia. Para tyre u shfaq deti dhe në të djathtë gjiri i Garicës, të cilin e kishin braktisur para shumë vitesh, atëherë kur Klelia shiti vilën e saj luksoze. Spiro hezitoi për një moment, por pastaj ktheu timonin majtas që të gjente ndonjë vend parkimi para Spianadhës, atij vendi me bukuri të rrallë.

Klelia zbriti nga makina, sikur të ishte zgjuar nga një gjumë letargjik. Mori frymë thellë dhe u mbush me erën e njohur të qytetit ku kishte lindur dhe ishte rritur, para se të kthehej nga çifti që po e shihte me kureshtje.

- Mirë jam, - pëshpëriti dhe buzëqeshi me trishtim.
- Kanë kaluar kaq vjet... Dhe gjithçka më duket njësoj si atëherë, megjithëse çdo gjë është krejt ndryshe!

- Eja të shkojmë tani, se u vonuam..., - e lëvizi me ngadalë Evgjenia.

- Jo. Shkoni ju te shenjti dhe ndizni dhe një qiri për mua!

- Nuk do të vish? E ç'do të bësh vetëm?

- Thua se do humbas? Dua të eci pak... të kujtoj përsëri... vendin... Mos kini merak për mua! Do takohemi në Liston për të pirë kafe! E pastaj hamë drekë diku në qytet.

- Në Liston?! - Evgjenisë iu duk sikur dikush i dha një goditje të fortë.

- Po Evgjëni! Në Liston! Sepse atje njoha..., - Klelia ndaloi papritur. Jo, emrin e tij e kishte shumë të vështirë ta thoshte... Ndoshta ngaqë kishte kaluar kohë e gjatë. - Niqiforin! - shtoi. Kjo e fundit u dëgjua si e shtë në pistolete. Edhe ajo që e kishte nxjerrë nga goja, vuri dorën në gjoks sikur donte të mbrohej nga plumbi.

- Shën Spiridhon, na ndihmo! - bëri kryqin Evgjënia.

Spiro, e pickoi fort në krah.

- Po, moj zonjë, - u kthye me të butë nga Klelia. - Dhe Niqiforin aty e njohe, dhe me Pavllon aty i bëre xhirot e para! Shko të kujtosh rininë tënde, s'është ndonjë gjë e keqe! Tashmë kanë kaluar kaq vjet...

- Ke të drejtë Spiro. Vetëm se ndonjëherë, më duket sikur ato vite nuk ikën kurrë. I mbaj mbi supe, e shikon... dhe janë të rënda.

Klelia u largua dhe pas pak humbi në Spianadhë.

Evgjënia u mbajt te burri i saj duke fërkuar krahun që i dhembte.

- Spiro, të marrtë e mira, të marrtë! Ma nxive krahun! Si të erdhi dhe fillove të më pickosh mu në mes të rrugës?

- Përderisa ti nuk kupton? U plake dhe mend nuk vure moj korfuziane e çmendur! Si bën kështu vetëm se zuri emrin e tij me gojë! Dhe të të them diçka? Edhe ne nuk kemi bërë mirë që nuk e kemi zënë me gojë gjithë këto vjet! Kujtimet që nuk i përmend, që nuk i ndan me të tjerët, zmadhohen dhe të mbysin! Një njeri që s'bëri hajër, që e gënjeu vajzën tonë, se ishte e njomë dhe e rritur me dashuri, që e gënjeu, që u tall me të, që...

- Do pushosh apo të ta thyej kafkën e pastaj t'i lutesh shenjtit të ta sjellë në vend? - e trembi Evgjenia dhe Spiro e kuptoi se e kishte tepruar.

- Hajde shkojmë, se u vonuam! - i tha dhe e futi në turmën e atyre që po nxitonin pasi ishin vonuar.

Klelia po atë ditë, u ngul në dhomën e nënës së saj, dhe si gjithmonë ndaloi fillimisht duke kundruar mobilet, perdet dhe tavolinën e tualetit të mbushur plot me shishka, të cilat me urdhër të Agapinosit kishin mbetur të paprekura. Por këtë radhë ia tërhoqi vëmendjen një baule. Mbi të ishin skalitur trëndafila dhe flutura shumë të bukura dhe vogëlushja iu afrua sikur po e tërhiqte një magnet. E hapi pa asnjë vështirësi dhe sytë e saj u hapën tej mase. E mbështjellë me një copë prej mëndafshi aty prehej fustani i nusërisë së mamasë së saj, me duar që i dridheshin ajo hoqi copën e bardhë që e mbështillte dhe me kujdes të madh nxori prej aty veshjen me një bukuri të veçantë. Brenda në baule ishin të gjitha. Ishin edhe këpucët e qëndisura që kishte veshur nusja, bashkë me dorashkat, kurorën dhe vellon. Pa u menduar gjatë, Klelia hoqi këpucët e saj, dhe veshi këpucët me taka të mamasë. Duke u parë para pasqyrës së saj, vuri edhe kurorën së bashku me vellon. Fustani i nusërisë ishte shumë i madh kështu që vetëm sa e mbajti para vetes dhe e vetëkënaqur u pa në pasqyrë. Pastaj, sikur t'i vinte turp, sikur të kishte bërë diçka të keqe, e hoqi dhe e vendosi në vendin e vet duke mbyllur baulen. Asnjëri nuk duhej ta merrte vesh se ç'kishte bërë, sepse mund

ta kritikonin e të mos e linin të hynte më aty. As vetë nuk e dinte se pse, po kishte nevojë të hynte në atë ambient, të thithte të njëjtin ajër që dikur kishte thithur nëna e saj, të shihte po ato gjëra që kishte parë dhe ajo. Pastaj shkoi në dhomën tjetër të cilën mamaja e saj e përdorte si zyrë. Pas mobilies së punuar me shumë shije, gjendej biblioteka e saj...

Klelia, pas kaq shumë vitesh që s'kishte shkelur në qytet, e ndjeu veten si turistë. Ndaloj duke parë me admirim Peristilin e Maitlantit. Po të kishte marrë me vete aparatën fotografik ndoshta do të kishte fotografuar ndërtesën në formë rrethore me kolonat e stilit jonik, që binte në sy në Spianadhë që në vitin 1816.

Por ajo e kishte braktisur atë ashtu si çdo gjë tjetër nga e kaluara. Një fllad i lehtë luante me flokët e saj, gjethet e pemëve rrotull saj belbëzuan një mirëseardhje dhe Klelia kuptoi se nuk ishte e gatshme që të rishihte Listonin. Të paktën jo akoma... Kaloi rrugën Kapodistria e u fut nëpër rrugica. U ndje e mbrojtur nga shtëpitë që e rrethonin, atmosfera e njohur, dhe aromat e këndshme sikur të mos ishin larguar kurrë nga kujtesa e saj. Pa dashje, u gjend duke ecur para dhjetëra dyqanesh turistike. Ishin shtuar shumë, dhe në qoftë se dikush thoshte se veç e veç ato dukeshin të shëmtuara, së bashku ato kishin një ngjyrë si të kishin dalë nga zemra e Korfuzit. U afrua te njëri prej tyre, preku enët prej balte ku ishte pikturuar harta e ishullit, dhe shishte me liker *kum kuat* që shpërndanin rreth e qark reflekse ngjyrë portokalli.

Ky vend i kujtoi një festë dhe ajo, papritur, e kuptoi se s'duhej të qëndronte më aty. Pas pak do të fillonte litania, njerëzit do shtoheshin më shumë, duhej të ikte. Si padashur këmbët e çuan në Liston...

Klelia u harrua në bibliotekën e nënës së saj. Librat e bukur i tërhoqën vëmendjen. As nga ato s'kuptonte gjë, por vetëm se i kishte prekur nëna e saj, e bënin për vete.

I prekte e entuziazmuar, i shfletonte e pastaj i vendoste me kujdes në vendin e tyre.

Në një moment, Evgjenia hyri në dhomë e trembur.

- Këtu je, zemra ime? Nga s'të kërkova, deri në bodrum vajta! U tremba!

- Përderisa të kisha thënë se ku do isha! - u justifikua Klelia.

- Nuk e mendova se do të rrije kaq shumë këtu brenda! Eja të hash e pasdite vjen përsëri! Këtu janë librat, nuk ikin!

Gjatë viteve të ardhshme, ajo dhomë u bë vendi i saj i preferuar. Pas vizitës në zyrën e babait të saj, gjërat ndryshuan. Agapinosi filloi të pyeste gjoja rastësisht Evgjeninë, për vajzën e tij dhe për rezultatet e saj në shkollë. Pa dijeninë e askujt, filloi ta ndiqte kur ajo ishte në kopsht bashkë me Spiron. Ndërkohë, nuk guxonte t'i afrohej më shumë. Kur Klelia mbaroi shkollën fillore, bëri atë veprim që asnjeri nuk e priste: e regjistroi vajzën në shkollën femërore më të mirë të Korfuzit. Evgjenia, kur e mori vesh këtë gjë, buzëqeshi e kënaqur. Më në fund, vajza e saj do të kishte atë që meritonte.

Atë vit ndodhën të gjitha ndryshimet, sikur në vilën luksoze të Agapinosit të kishte fryrë një erë magjike. Vilën në krah e bleu familja e Llagunarit nga Zakintho. Shtëpia e tyre ishte shkatërruar nga tërmetet që rrafshuan ishullin në vitin 1953. E rindërtuan vilën e tyre, u rimëkëmbën, por përfundimisht vendosën se nuk mund të jetonin më në një vend që u kujtonte kaq të këqija. I shitën të gjitha ç'kishin dhe u transferuan në Korfuz, nga e kishte origjinën Ana Llagunari, gruaja elegante e shtëpisë fqinje. Konstandin Llagunari, burri i saj, ishte shumë më i madh se ajo në moshë, por ai e adhuronte, ashtu siç e adhuronte dhe ajo atë. Djali i tyre i vetëm, Pavllo, ishte shumë i pashëm, atij i duhej edhe një vit që të mbaronte shkollën dhe i vetmi pasion i tij ishte muzika. Nga dritaret e hapura të vilës së tyre, çdo ditë dëgjoheshin meloditë që dilnin nga duart e tij kur ato përkëdhelnin pianon e madhe.

Familjet, normalisht nuk do kishin më shumë se një përshëndetje, por Ana Llagunari ishte shumë kurioze të njihnte pronarin e vetëm të shtëpisë përbri, historinë prekëse të të cilit ia kishin treguar zonjat e tjera fqinje, me të cilat u njoh sa u vendos në Korfuz.

Nuk ishte e vështirë të bindte bashkëshortin e saj që bashkë me Pavllon të bënte një vizitë formale në shtëpinë e Agapinosit. Aq më shumë, që do ta ngarkonte atë të merrej me të gjitha çështjet e tij juridike. A s'ishte avokat?

Kjo vizitë e tyre e gjeti Agapinosin si gjithnjë në zyrën e tij, por aty ishte prezent edhe Klelia. Kishte zgjedhur atë ditë për t'i kthyer babait të saj një libër, që e gjeti në bibliotekën e nënës së saj, që mesa duket u gjend atje gabimisht. Kur shërbyesja njoftoi mbërritjen

e Llagunarit dhe të të birit, Klelia si zonjë shtëpie dha urdhrin e duhur.

- Të hyjnë! Shoqëroji zotërinjtë në sallon dhe po vijmë edhe ne! Lajmëro të përgatisin kafetë dhe ëmbëlsirat!

Agapinosi mbeti si i habitur, kur dëgjoji vajzën e tij të sillej si zonjë shtëpie, ngaqë nuk e dinte se Evgjenia kishte bërë një punë të veçantë në edukimin e saj, duke e përgatitur kështu që të vogël për t'u bërë një zonjëz e vërtetë.

- Ç'bëre? - e pyeti ashpër ai. - Kush të tha se desha të prisja njerëz që nuk i njoh?

- Baba, po zotërinjtë para disa muajsh kanë blerë shtëpinë ngjitur! Natyrisht që tamam atë duan: të na njohin! Do të ishte e pahijshme po të mos i prisnim! Evgjenia thotë gjithmonë se çdokush më parë sheh fqinjën e tij e pastaj Zotin! Urdhëroni!

Agapinosi nuk po besonte asgjë nga ato që po ndodhnin. Vajza e tij, fare papritur kishte marrë përsipër rolin e zonjës së shtëpisë, si të ishte diçka krejt e natyrshme. E ndoqi kur ajo po drejtohej për në sallonin e pritjes. Ishte shumë e gjatë për moshën dhe feminiteti i saj kishte filluar të bëhej i dukshëm. Sa vinte dhe ngjante më shumë me mamanë e saj. E dëgjoji tek fliste me vizitorët dhe e kuptoi se duhej të hynte dhe ai.

Klelia u gjend në Liston pa e kuptuar as vetë. Sytë e saj përkëdhelën me dashuri harqet e tij, bile edhe suvaja që kishte rënë aty këtu ngjante me penelata boje që përsosnin tablonë. Dielli lodronte mes pemëve,

ai prekte me dashuri ndërtesat e vjetra dhe ndalonte papritur në çadrat gjigante, të cilat mbronin nga dielli klientët që pinin kafënë e tyre. Ajo zgjodhi të rrinte pranë një kamareje. Ishte e djersitur jo nga vapa por nga përpjekja për... Nga përpjekja për ta detyruar veten që të mos dorëzohej... Kambanat tashmë po binin... po fillonte litania. Pak më vonë do të kalonte edhe para saj. Pas saj do vinin njerëzit, e në mes tyre djem e vajza, të gatshëm për të ndier rrahjet e para të dashurisë, ashtu si ajo dikur.

I dha porosinë kamerierit, që për fat të mirë nuk e njihte, dhe guxoi të shihte rrotull saj. Të gjithë ishin fytyra të panjohura. Asnjëri nuk i kujtonte asgjë. Ku gjendeshin vallë vajzat me të cilat luante kur ishte fëmijë? Adela me atë të qeshurën e saj të fortë, Aneta me sytë e mëdhenj? Sigurisht që ishin martuar, kishin fëmijë dhe ndoshta edhe nipër... I kërkoi cigaret e saj gjithandej, por më në fund e kuptoi se i kishte harruar. Përballë kishte një kinkaleri dhe Klelia kaloi rrugën mes për mes. Shitësi e pa me kujdes. Po ai ishte, i njëjti. Pak i plakur, por e njohu. Ndërsa ai nuk ishte i sigurt dhe nuk guxoi ta pyeste nëse ajo ishte vajza e vetme e Agapinosit. Klelia mori me nxitim cigaret dhe u kthye në vendin e saj, në momentin që kamerieri po vendoste kafënë mbi tavolinë. Procedura e njohur e qetësoi. Kafeina dhe nikotina, zakonet e këqija të saj, e ndihmuan trurin të kthjellohej dhe atë vetë të fitonte qetësinë e saj. Pas njëfarë kohe, gjysmë e fshehur nga kolona që kishte përpara, pa të kalonte para saj skeleti i shenjtit, me bandën dhe njësitë ushtarake që e shoqëronin, si dhe turma e njerëzve që i ndiqnin. Midis njerëzve dalloi Evgjeninë dhe Spiron, të cilët

po e kërkonin gjithë ankth, dhe u buzëqeshi që t'i qetësonte. Arriti të dallonte shqetësimin e tyre. Që kur kishte filluar të mbante mend veten, ata nuk u larguan kurrë prej saj. Përjetuan bashkë me të çdo gëzim e çdo hidhërim, i qëndruan afër për të fshirë çdo lot dhe lotët e saj ishin aq të shumtë... Mori frymë thellë. Nëse nuk do të kishte pasur pranë ata të dy, do kishte marrë fund, tashmë e dinte shumë mirë këtë gjë.

Pavlo e kuptonte se sjellja e tij mund të dukej ndoshta e çuditshme, por nuk bënte dot ndryshe. Krijesa mahnitëse para syve të tij e linte pa frymë, i shkaktonte zjarrmi në kokë. Lëvizjet e saj i ngjanin me lëvizje vallëzimi dhe ai kërcente tango bashkë me të.

Zëri i saj, akoma fëmijëror, por i butë si prej kadifeje, i sillte harmoni. Babai i tij bisedonte me babanë e saj për punë dhe ajo i dëgjonte me vëmendje, por në veshët e tij arrinte vetëm një oshtimë. Izolimi i tij në ritmet e ëmbla të dashurisë u shkëput nga vetë ajo, që u kthye drejt tij dhe i nguli sytë e saj ngjyrë gri.

- Vërtet, çdo ditë dëgjoj muzikë shumë të bukur nga shtëpia juaj. Dikush i bie pianos. Kush i bie? - e pyeti me zë të ulët që të mos ndërpriste të rriturit që po bisedonin.

- U... unë..., - iu mor goja Pavllos. - Shpresoj të mos ju kem shqetësuar...

- As mos të të shkojë në mend një gjë e tillë! Unë nuk kam fare talent për muzikë. Kam lindur e jam rritur në Korfuz dhe nuk kam fare formim muzikor. E imagjinon dot?

- Unë të vetmen gjë që dashuroj është muzika, - iu përgjigj ai dhe lutej që gjaku që ishte ngjitur deri te faqet e tij të mos i kishte skuqur ato. Gjithë ai burrë dhe skuqej se po fliste me një vajzë dymbëdhjetë-trembëdhjetë vjeçare!

- Të pengoj po të vij ndonjë ditë të më luash pak muzikë në piano? - e pyeti ajo.

- Me kënaqësi! Kur do të vish? - murmuriti duke mos i besuar fatit të tij.

- Të vij nesër pasdite? - propozoi Klelia. - Nuk kam shumë mësimë!

- Do të të pres!

Edhe nëse Agapinosi, do të donte ta mbante këtë lidhje në nivelin e formalitetit, do ta kishte të vështirë, pasi që nga çasti kur u njohën vajza e tij dhe Pavlo u bënë të pandarë. Ana Llagunari u çmend fare pas vajzës bukuroshe, që u bë si e shtëpisë, dhe e vërteta është se ajo plotësoi ciklin e formimit të Klelias, në atë se si duhej të sillej një zonjë e vërtetë. Megjithëse në vitet shtatëdhjetë, njerëzit kishin filluar të çliroheshin disi nga formalitetet, ajo mbartte me vete mendime të prera në lidhje me sjelljen e një zonje, dhe përpiquej t'ia transmetonte Klelias, por jo me lehtësi. Shpirti rebel i së mbrojturës prej saj, përbënte një pengesë të madhe për të.

Ana nuk ishte qorre. Shihte, kuptonte se i biri ishte dashuruar si i çmendur me Klelian. Në fillim u gëzua, por më vonë filloi të shqetësohej. Vogëlushja dukej hapur se e shihte si shok, si vëlla dhe nuk i shkonte fare nëpër mend se Pavlo nxirrte gjak nga çdo pore e trupit të tij për të. Çdo ditë e më shumë, Klelia përfaqësonte gjithçka për të. Gishtërinjtë e tij e preknin pianon me

një pasion të tillë, nga ku nëna e tij kuptonte se për atë ishte si të prekte ëndrrën e tij. Muzika e tij bëhej çdo ditë e më pasionante dhe tensioni në fytyrën e tij kur luante në piano, i zbulonte se djali i saj do zhytej në monopate të vështira me një dashuri pa përgjigje.

Evgjenia u shemb në një karrige përballë Klelias dhe Spiro gjithashtu bëri të njëjtën gjë.

- Nuk jam për të ardhur më në litani! - u qa gruaja e moshuar duke shtrembëruar fytyrën. M'u ndezën këmbët!

- Po dhe ju pse s'e latë në mes? Ishte e domosdoshme të shkonit deri në fund? - komentoi Klelia, duke i bërë shenjë kamerierit të vinte të merrte porosinë.

- Atë i thashë edhe unë! - u hodh Spiro. - Po pse dëgjon kjo? Nuk dëgjon! Asnjëherë s'më ka dëgjuar dhe pastaj qahet!

- Pusho dhe ti! - e pa me egërsi e shoqja. - Vite të tëra kishim pa ardhur në nderimin e tij dhe unë do e kisha mendjen te këmbët. Hajde boll edhe ti! E pastaj do rrimë këtu, do pimë kafën dhe do çlodhem! Po ti moj zonjë? Ç'bëre vetëm gjatë gjithë kësaj kohe?

Klelia porositi njëherë kafetë, dhe pastaj u kthye nga Evgjenia.

- Dola një shëtitje nëpër rrugica... Gjithandej janë hapur dyqane turistike! - iu përgjigj. - Ka ndryshuar qyteti, por përsëri... i njëjti është... A s'është e çuditshme kjo gjë? Vallë ç'do jetë bërë shtëpia ime?

- Aty, e dashura ime, janë ndërtuar apartamente, - iu përgjigj Spiro. - Edhe te shtëpia e Llagunarit po njësoj. Apartamente të mëdha e të shtrenjta. Vilat

i prishën. Natyrisht në dukje ngjajnë me shtëpitë e vjetra, fatmirësisht...

- Po ti, nga e di? - donte të mësonte Klelia dhe duart po i dridheshin kur ndezi edhe një cigare tjetër.

- Unë vij ndonjëherë në qytet, - u përgjigj Spiro me zë fajtori, thua se kishte kryer një padrejtësi.

- Mirë, mirë, mos u vë në siklet! Unë gjatë gjithë këtyre viteve nuk desha vetë të shkelja, ndërsa ti nuk kishe arsye pse të mos vije! Spiro, të mungon qyteti?

- Po... Këtu kalova shumë mirë. Këtu u martova me Evgjeninë, këtu njohëm zotërinë... këtu u linde ti dhe të mbajtëm në krahë... Ja, këtu përballë luaje kur ishe fëmijë dhe ne pinim kafënë dhe krenoheshim me ty...

- Për të mirë na daltë, sot për ditë të diele! - iu vërsul gruaja e tij. - Tani do t'i kujtosh të gjitha? Ç'të zuri?

- Ka të drejtë, Evgjeni, mos e kritiko. Unë e kam fajin. Ju mora dhe ju mbylla në shkretëtirë për kaq vjet. Asnjëherë nuk ju pyeta çfarë ndjetë kur shita shtëpinë. Ju shkula me rrënjë ngaqë unë s'po duroja dot më gabimet e mia... Dhe ishte e vetmja mënyrë që të shkëpitesha prej tyre...

- E, ç'e donim shëtitjen? - psherëtiu Evgjenia. - E dija unë se s'do na dilte për të mirë! Dhe të kam edhe ty, shpirti im, që më thua çmendurira! - Evgjenia nuk e ndërpreu frymëzimin e saj as kur erdhi kamerieri me kafetë. - E ku doje që të shkonim ne, përderisa ti do ikje? Mund të të linim vetëm? Në shkretëtirë ti, në shkretëtirë edhe ne! Dhe në... Polin e Veriut të shkoje, përsëri pas do na kishe! Kemi njeri tjetër përveç teje? Ti je fëmija ynë! Je gëzimi ynë! Zonja jonë! Vetëm se... Evgjenia ndërpreu menjëherë bisedën e saj.

- Ç'pate? Pse e ndërpreve fjalimin? - e ngacmoi Klelia që të fshihte emocionet e saj.

- Po, ja, zemra ime... Mendoj se bëre gabim...

- Vetëm një?!

- Njëri ishte më kryesori... Që zbove Pavllon. Vetëm ai të dashuroi me të vërtetë. Vetëm me të do ishe e lumtur dhe bashkë me ty do gëzoheshim edhe ne. Do i mbyllnim sytë të qetë kur të na vinte ora...

- Hajde, moj grua! E hape përsëri atë kutinë tënde dhe s' di se ç' thua! - e ndërpreu Spiro që pa Klelian të zbehej kur dëgjoi fjalët e fundit të Evgjenisë. - Mos e dëgjo, zemra ime! I bëri keq livanda e shenjtit dhe ecja në këmbë!

Klelia humbi për pak vështrimin e saj në det, tek ajo hije, që ndoshta ishte ndonjë sirenë të cilën e takonte gjithmonë kur udhëtonte me varkën e saj për nga shpellat. Ndoshta më në fund ajo do ta ndiqte nga pas që t'i tregonte se cili ishte momenti kur jeta e saj mori drejtimin e gabuar. Ndoshta tani Evgjenia po fliste me fjalët e sirenës. Mendimet iu vërsulën për ta mbytur, goja iu mbush me ujë deti, sirena e tërhiqte poshtë, në thellësi, dhe i tregonte një sënduk, që koha e kishte zbukuruar me leshterikë, korale dhe guaska të thyera.

- *Aty, - i tha prerë. - Aty është jeta jote... e varrosur... bashkë me gabimet e tua... Hape sëndukun dhe përballu me to! Numëroji! Aty brenda do e gjesh se ku bëre gabim! Kaq vite këtë kërkon të të jap! Pra erdhi momenti!*

Kur u kthye për të ikur, që ta linte vetëm me jetën e saj, flokët e sirenës u mbështollën përreth saj si gjarpërinj. Bishti i saj u tund lehtë dhe pastaj shkoi pas disa shkëmbinjve, dhe ajo mbeti vetëm para sëndukut

të mbyllur. Dora e saj lëvizi, ngriti kapakun dhe ferri u derdh nga thellësitë e tij, dhjetëra zëra mbytën veshët e saj, pamjet u ngatërruan dhe pastaj... papritur, u vunë të gjitha në radhë.

Koralek...

Viti i Ri 1975 do të mbetet i skalitur përgjithnjë në kujtesën e Pavlos. Me rastin e Vitit të Ri, në shtëpinë e tij do festonin dhe, natyrisht, mamaja e tij të parët që ftoi, ishin Agapinosi së bashku me vajzën e tij. Kur ky i fundit e refuzoi ftesën me shumë edukatë, Ana i shkoi në shtëpi dhe u mbyllën të dy në zyrën e tij. Evgjenia megjithëse bëri luftë me veten, nuk mundi t'i pengonte këmbët e saj që ta çonin jashtë derës së asaj dhome, dhe as nuk mundi ta përmbante veten që të mos vinte veshin prapa derës. Ajo po e dëgjonte bisedën e tyre, sikur të ishte brenda në zyrë.

- Mund të di pse e kundërshtove ftesën time për të marrë pjesë në darkën festive të Vitit të Ri? - e pyeti Ana, Agapinosin. - Je i ftuar edhe diku tjetër?

- Ç'është kjo pyetje? Kundërshtova sepse... sepse...,
- Rikardo s'dinte ç'të thoshte.

- Po? Po pres të dëgjoj arsyen!

- E ç'ëndësi ka? Nuk mund të vij në shtëpinë tuaj!

- Gjatë këtyre viteve që jemi fqinjë, ke ardhur shpesh në shtëpinë tonë! - e kujtoi ajo.

- Po, por ishim vetëm... Në darkë do ketë shumë njerëz... Nuk do të jetë njësoj...

- Ashtu është! E ç'ka këtu për të pasur frikë? Do hamë, do pimë, do kërcejmë, do luajmë letra, do argëtohemi! Nga kjo ke frikë! Apo jo? Ke frikë se mos ia kalon mirë, dhe me atë mendjen tënde të sëmurë, beson se kështu do tradhtosh kujtimin e saj!

- Nuk ta lejoj! - Agapinosi goditi tavolinën me grusht, por Anës nuk i lëvizi as qerpiku.

- Nëse do bëhej fjalë vetëm për ty, nuk do të të flisja kështu! - iu përgjigj qetë ajo. - Por bëhet fjalë dhe për Klelian! Është gati pesëmbëdhjetë vjeç! Një zonjushë e vërtetë dhe madje shumë e bukur! Duhet të dalë në dynja!

- Klelias s'ka ç'i duhet darka jote! Ajo del me shoqet e saj...

- Fatmirësisht shkon në shkollë! Po, del edhe me Pavllon shëtitje në qytet dhe bëjnë xhiro në Liston! Shkëlqyeshëm! Por vajza juaj rrjedh nga një familje e mirë dhe nesër pasnesër do t'i duhet të martohet!

- Ç'po thua tani? Në çfarë shekulli jeton? Si mendon domethënë? Që... vajza ime, kur t'i vijë momenti, duhet të zgjedhë një dhëndër që emri i tij të jetë i shkruar në Libro d'Oro? Jetojmë në vitet '70, dhe jo në vitet 1800! Nuk ekzistojnë më fisnikë dhe plebenj.

- Atëherë jepja vajzën hamallit të portit. Mirë, mirë, e lëmë njëherë për njëherë martesën. E imagjimon dot vajzën tënde të mbetet vetëm atë natë dhe te shtëpia ngjitur të kërcasë ahengu?

- Por unë nuk thashë të mos vijë Klelia!

- Si, të vijë e pashoqëruar?!
- Besoj se djali juaj do ishte më se i lumtur, nëse merrte përsipër detyrën e shoqëruesit të saj!
- Nuk është njësoj, dhe besoj se e kupton këtë! Të lutem, Rikardo! Bëj një hap para! Të paktën hajde, rri deri sa të ndërrohen vitet, e pastaj shko dhe kur të mbarojmë e shoqëron Pavllo Klelian për në shtëpi! Nuk po të kërkoj as të kërcesh, as të këndosh! Do luash letra me Konstandinin!
- Mund të më thuash se përse po ngul kaq shumë këmbë që të vij? Nuk besoj se më ke ngritur ndonjë kurth?
- Ç'do të thuash me këtë?
- Ana, po qe ndonjë krushqi në mes...
- Rikardo, je në vete? Të dhashë ndonjëherë shkak që të mendosh se dua të të bëj krushqi? E respektoj plotësisht vendimin tënd, e di, e kam marrë vesh se sa shumë e dashuroje gruan tënde dhe nuk do guxoja kurrë të bëja një gjë të tillë. Vërtet është e dhimbshme, por dhe nuk duhet të arrije deri në këtë ekstrem ku ke arritur ti!
- Ç'do të thuash?
- Atë që kuptove! U varrose i gjallë brenda në atë shtëpi dhe po të mos ishte Evgjenia, do kishe varrosur dhe vajzën tënde të vetme. I tërë Korfuzi flet prapa krahëve të tu, për mënyrën se si le pas dore edukimin e vajzës tënde të vetme, dhe e dorëzove në duart e dy njerëzve, që fatmirësisht, ajo që u mungon në kulturë e plotësojnë me dashurinë e tyre!
- E kupton që po ndërhysh në çështjet e mia familjare?
- E di dhe më vjen keq që më detyrove ta bëj këtë! Jemi fqinjë për afro tre vjet, por vajzën tënde e dua

shumë... Është një krijesë e rrallë... ashtu siç ishte dhe gruaja jote. Për saktësi është kopje besnike e saj. Klelia më tregoi fotografitë e saj dhe të tuat. Një çift i mrekullueshëm, për të cilin fati u bë xheloz. Por çfarëdo që të bësh, Luçia nuk do të kthehet më, ndërsa Klelia e SAJ është këtu! E gjallë dhe tej mase e bukur, njësoj si e ëma! Duhet të të vijë keq që sillesh kështu me të! Rikardo, njihe vajzën tënde, nuk është vonë! Dhe nëse do ta kishe bërë që në fillim, nëse do ta kishe mbajtur në duart e tua për ta rritur, gruaja jote do të të mungonte më pak dhe dhimbja do të të zbutej më shpejt...

Evgjenia, mirë që arriti të largohej, se Ana doli me shumë nxitim, ashtu siç kishte ardhur. Nga dera e hapur pas saj, ajo pa zotërinë që po qëndronte si statujë në mes të dhomës me vështrimin të ngulur në boshllëk. Ajo u largua ngadalë pa e shqetësuar. Pak më vonë iku me nxitim për te Shën Spiridhoni.

Sapo hyri në kishë, në atë kishë aq të bukur, u drejtua drejt pjesës në krah të altarit, ku gjendej arkivoli i larë me argjend me skeletin e shenjtorit, dhe u gjunjëzua para tij.

“Shenjti im, ti që bërë gjithë ato mrekulli për të shpëtuar ishullin tonë, bëj edhe një akoma. Ndriçoje mendjen e tim zoti... bëje që të shohë të vërtetën që i thotë ajo grua. Bëje që të dojë vajzën e tij!” - pëshpëriti.

Përfundimisht asnjëri nuk e mori vesh nëse e bëri Shën Spiridhoni atë mrekulli apo ia kishte dhënë këtë nder Ana Llagunarit...

Rikardo e dinte se në atë kohë Klelia ndodhej në shtëpi dhe e kërkoi. Krishtlindjet donin edhe katër ditë që të vinin dhe vajza e tij së bashku me Evgjeninë

kishin zbukuruar shtëpinë. Për të zbukuruar shtëpinë me lule, Klelia kishte ngarkuar Pavllon. Asnjëherë tjetër nuk ishte interesuar për zbukurimin festiv të shtëpisë, por sivjet ishte ndryshe. E pranoi se vajza e tij kishte bërë një punë të lavdërueshme, dhe ishte surprizuar kur kishte marrë vesh se e bija së bashku me Evgjeninë, kishin vizituar disa jetimore për të shpërndarë ëmbëlsira dhe dhurata për fëmijët, ashtu siç bënte gjithnjë gruaja e tij për Krishtlindje dhe Pashkë. Trokiti në derën e dhomës së saj por nuk mori përgjigje. Atëherë vuri re se dera e dhomës së gruas së tij ishte e gjysmë e hapur dhe u drejtua me ngadalë për aty, i sigurt se Klelia do të ishte përsëri aty, ashtu siç bënte shpesh. Vetëm se nga ajo që pa desh i pushoi zemra. U detyrua të mbahej në mur që të mos rrëzohej, këmbët iu përkulën nga pesha e asaj pamjeje të pabesueshme. Para pasqyrës së tualetit të saj, qëndronte ajo, Luçia, e veshur me fustanin e saj të nusërisë. Flokët e saj të zinj, të ngritura lart, njësoj si atëherë, me disa bukle të pabindura që i dilnin nga kurora e bardhë, e bënë më të theksuar kontrastin me copën e bardhë prej mëndafshi. Sytë e saj shihnin shëmbëllimin në pasqyrë, dhe buzëqeshnin.

Kur u turr për të hyrë në dhomë, fryma i doli si grahma e fundit e vdekjes.

- Luçie! - pëshpëriti dhe qëndroi si i humbur para vegimit të bardhë.

- Baba, jam unë, Klelia! - iu përgjigj vajza e trembur nga mënyra se si ai u fut në dhomë.

Më pas, Agapinosi bëri me mundim disa hapa, por menjëherë u shemb në krevat, duke marrë frymë me vështirësi nga tronditja që pësoi.

Vajza e tij iu afrua e shqetësuar.

- Jeni mirë? T'ju sjell pak ujë? Të thërras doktorin?
- e pyeste ndërkohë që i zgjidhte kravatën dhe i zbërthente këmishën.

- S'kam gjë..., - iu përgjigj me zor ai. - Do e marr veten.

Ai pa me admirim përreth tij, para se ta ndalte vështrimin te vajza, e cila po hiqte me kujdes kurorën nga flokët.

- Do ta heq menjëherë..., - vazhdoi vajza.

Por i ati e ndaloi, duke i mbajtur dorën, në të cilën kishte veshur dorashkat e mamasë së saj.

- S'ka gjë, bija ime..., - i tha dhe ëmbëlsia e zërit të tij, që ajo e dëgjoi për herë të parë, e trembi edhe më shumë, që padashur bëri një hap prapa. - Ulu pak pranë meje..., - i kërkoi ai.

Klelia hezitoi për një moment, por pastaj bëri atë që i kërkoi i ati.

- Të tremba? - e pyeti me të butë.

- Po... domethënë... u tremba për ju...

- Pse më flet në shumës? - vazhdoi ai papritur.

- Nuk e di... Që kur isha e vogël kështu ju thërrisja dhe kurrë nuk më korrigjuat. Asnjëra prej shoqeve të mia nuk i flet prindërve në shumës, por nuk është njëllloj...

- Saktë... Ne të dy jemi paksa të huaj...

- Nuk e kam unë fajin për këtë! - u përgjigj Klelia me guxim, por menjëherë u pendua.

- Asnjëherë mos u pendo kur thua të vërtetën! Jo... nuk ke faj ti... Unë jam ai që nuk të afrova kurrë..., - pëshpëriti.

- Pse?

Pyetja njërrokëshe, që të kujtonte verdiktin e dënimit, u end për njëfarë kohe në dhomë, para se Agapinosi të guxonte të përgjigjej.

- Erdhe në këtë botë dhe ma more..., - tha ai me zë të ulët.

- Por s'e kisha unë fajin! Nëse do më ishte dhënë mundësia e zgjedhjes, nuk do zgjidhja kurrë humbjen e mamasë time!

- Po i flet me logjikë një të çmenduri, se ashtu u bëra unë pasi e humba atë. Pastaj, i ngjan aq shumë asaj... Nuk duroja dot që të shihja Luçien te ty. Doja atë vetë, jo kopjen e saj...

- U treguat shumë i padrejtë me mua..., - tha vajza.

- Po... dhe erdha të të kërkoj të falur. Të përpiqemi që të dy që të njihemi...

- Pse?

Përsëri e njëjta pyetje. Dhe përsëri fshihte brenda saj akuzë.

- Ka rëndësi? - iu kthye ai. Ndërkohë s'kishte asgjë tjetër për t'i thënë. - Ndoshta tani po plakem dhe kam nevojë për ty..., - i shpëtoi atij.

- Po kur unë kisha nevojë për ty? - Pyetje e drejtë!
- Nuk po tregohesh ca egoist?

- Po... ndoshta. Por nuk kam asgjë tjetër për të të thënë, vetëm të kërkoj një mundësi, nëse mund të ma japësh.

Vajza i nguli sytë e saj te sytë e tij dhe ai me shumë mundim nuk e uli vështrimin, nga turpi dhe nga dhimbja. Sytë gri tashmë ishin errësuar shumë, kërkonin që të shihnin në sytë e tij një të vërtetë që të mund ta besonin.

- Nuk e di..., - iu përgjigj me sinqeritet. - Ndoshta është vonë... ndoshta dhe mund t'ia dalim... të vetmen gjë që mund të them, është se do të përpiqem.

Deklarata e saj e matur, e çuditë. E çarmatosi sinqeriteti i fjalëve të saj, që i dukeshin kaq të papërshtatshme për një fëmijë të moshës së saj. Vështrimi i saj e mposhti. Zgjati dorën dhe i përkëdheli faqen. U ngushëllua me faktin se ajo nuk u tërhoq. Klelia hezitoi për një çast, por pastaj, me ndrojtje, u përkul dhe i dha një të puthur në faqe. Puthja e parë që mori nga vajza e tij...

Ajo u largua me vrap që të ndërrohej, por Agapinosi nuk po arrinte të mblidhte veten. Faqja i digjte nga ajo ndjenjë që përjetoi për herë të parë, iu duk sikur po e përkëdhelte një frymë e freskët që kishte aromën e Luçies. Buzëqeshi. Kishte aprovimin e saj...

Libri *Dalje në Sipërfaqe* ra në duart e Klelias krejt rastësisht pasditen e Krishtlindjeve. Shiu binte pa pushim, Evgjenia me Spiron kishin vajtur në Kinopiastes për të parë të afërmit e tyre dhe Pavllo kishte dalë me prindërit për të bërë disa vizita te të afërmit. Shiu binte me forcë dhe i ngrinte nervat. Babai i saj kishte dhimbje koke dhe pasi i kishte kërkuar disa herë falje që do ta linte vetëm, ishte mbyllur në dhomën e tij. Kohët e fundit, sjellja e tij i ngjallte dyshime. E ndiqte vazhdimisht dhe donte të mësonte çdo gjë në lidhje me të...

E çuditshme... Përsëri, duke diskutuar me të, vuri re se ajo figurë e heshtur dhe e errët, që e njihte si babanë e saj, dinte të fliste bukur, kishte një kulturë të veçantë, dhe kishte shumë humor. Kjo e fundit ishte ajo që e

çudiste më shumë Klelian. Ajo nuk mund ta pranonte se një njeri i tillë arriti aty ku kishte arritur ai...

Kur ajo hyri në dhomën e mamasë së saj një rrufe e fortë i bëri xhamat të dridheshin.

E mërzhitur iu afrua bibliotekës dhe filloi të shfletonte librat, me qëllim që të lexonte librin e parë që do t'i kapte dora. Titulli *Fejesë e fshehtë* e tërhoqi dhe ngriti dorën ta merrte, por sa e preku librin, toka u tund nga themelet nga një rrufe e zemëruar dhe ajo u hodh përpjetë nga frika. Dora e saj u zhvendos dhe ajo tërhoqi librin ngjitur me të, *Dalje në sipërfaqe*.

E shfletoi dhe sytë i ngelën tek emri i personazhit kryesor.

“Klelia! - tha me vete. - Personazhin kryesor e quajnë Klelia! E imagjinon dot!”

U zhyt në kolltukun e rehatshëm të nënës së saj, dhe ndezi abazhurin. Sa e hapi librin, koha për vajzën u ndal në vend. U harrua duke lexuar historinë romantike. Thithte çdo fjalë pa mundur të ndalonte. Dhe vetëm emri i njëjtë me heroinën e librit e bëri të identifikohet me konteshën e bukur të cilën e dashuronin dy vëllezër. Kur ndeshi dhe emrin Pavlo, u rrëqeth....

Evgjenia, kur u kthye në darkë dhe e gjeti duke fjetur në kolltukun e nënës së saj me librin *Dalje në sipërfaqe* në duar, u lëshua duke qarë me dënësë. Klelia, sikur e ndjeu se diçka po ndodhte, hapi sytë, dhe pa gruan duke qarë me ngadalë, e ulur në këmbët e saj.

U ngrit përnjëherë.

- Evgjeni, pse po qan? - e pyeti e trembur. - Pësoi gjë njeri?

- Jo, zemra ime! Por u ktheva dhe të gjeta të ulur te kolltuku, duke lexuar librin e saj të preferuar!

- E lexonte këtë libër mamaja ime?

- Ishte libri i saj i preferuar... e kishte mësuar përmendësh! Ndonjëherë më thoshte dhe mua që t'ia lexoja...

- Evgjeni... heroinën ... e quajnë Klelia.

- Po... Dhe kështu na urdhëroi të ta vinim emrin para se të vdiste. Dhe ndonëse të gjithë u çuditën, unë e dija. Prandaj kur të pashë duke fjetur me atë libër në prehër, m'u kujtua ajo.

- Njërin nga ata që e dashuruan... e quanin Pavlo...

- Po... edhe ty të dashuron Pavlo.

- Ç'thua moj, Pavlo është shoku im.

- Por ai të dashuron...

- Shokët e duan njëri-tjetrin. Nuk është dashuri kjo. Mos i ngatërro gjërat.

- Shpresoj që të jetë kështu!

- Pse? Ti beson se Pavlo më do... Ndryshe? Është e pamundur! Gjithmonë ka dashur të kishte një motër dhe unë të kisha një vëlla. Kjo është e tëra.

- Ashtu qoftë. Përndryshe do mërzitet shumë i shkreti.

- Me sa shoh, meqë mamasë i pëlqente shumë *Dalja në sipërfaqe* të bëri edhe ty t'i shihje gjërat siç i shihte ajo! Se po të jetë kështu siç thua ti, duhet të gjendet edhe një Denis!

Evgjenia nuk tha asgjë. Ndërkohë i dhuroi një buzëqeshje, të cilën Klelia nuk mundi ta interpretonte, dhe e drejtoi për në krevatin e saj.

Pavlo e kishte lexuar këtë vepër të shkrimtarit Grigor Ksenopulo, por nuk kundërshtoi kur Klelia i

tha që ta lexonin së bashku. Për orë të tëra zëri i tij i ëmbël e gjallëronte atë histori plot ndjenjë, por me fund tragjik; pasioni i dallohej në fytyrë kur lexonte për Pavllon dhe ndjenjat e tij. Vajza, e ulur pranë tij, nuk ngopej duke e dëgjuar.

Mbrëmja e Vitit të Ri arriti dhe Rikardo po priste në sallon të zbriste e bija që të shkonin për darkë te Llagunarët. Mbushi një gotë me pije për veten dhe u ul ta shijonte duke e pirë të shoqëruar me puro. Mbrëmja e sotme ishte e vështirë për të, kishte kaq vjet që ishte shkëputur nga jeta shoqërore dhe i dukej sikur kishin kaluar shekuj. Vetëm në zyrën e tij ndihej i sigurt. Rrallëherë klientët ishin kompetencë e tij, ngaqë kishte bashkëpunëtorë shumë të zotë që e shqetësonin vetëm kur ndeshnin ndonjë problem të vështirë për t'u zgjidhur. Në shtëpi, biblioteka ishte vendi ku ai gjente qetësi. Marrëdhënia me të bijën, marrëdhënie të cilën ai e kishte përdorur aq keq, e habiti në mënyrë të kënaqshme. Klelia ishte shumë e zgjuar, dukej që e dëgjonte me kujdes dhe vërejtjet e saj e kënaqnin. Brenda kësaj periudhe të shkurtër që ai e zbuloi si njeri dhe jo si një hije shqetësuese, zbuloi se kishin diçka të përbashkët. Vajzës së tij i pëlqente shumë të mësonte për vende të tjera, të studionte harta, tradita, por nguronte për të udhëtuar. Dukej sikur kishte një vartësi të çuditshme nga Korfuzi që e mbante lidhur.

Hyrja e saj në sallon, e bëri të linte pijen dhe të ngrihej për ta pritur duke i hedhur një vështrim admirues. Pas saj vinte Evgjenia duke buzëqeshur, dhe duke u krenuar për vajzën e saj të bukur që aq shumë e adhuronte.

Klelia pa babanë e saj dhe buzëqeshi edhe ajo me ironi.

- Hë, si të dukem? - e pyeti dhe Agapinosi para se të përgjigjej i puthi dorën.

- Besoj se sot në shtëpinë e Llagunarëve, do të më kenë zili të gjithë! - u përgjigj dhe Klelia qeshi me të madhe.

- Fustanin ma zgjodhi zonja Ana! - i tregoi ajo.

- E kam thënë gjithmonë se ajo grua ka një shije të përkryer! - u shpreh babai i saj.

- Nuk e di a do thuash të njëjtat fjalë edhe kur të shohësh faturën? - e ngacmoi Klelia. - Asnjëherë nuk kam veshur diçka kaq të shtrenjtë.

- Të shkon kaq shumë, ngaqë je shumë e çmuar! - pëshpëriti i ati dhe Evgjenia nxitoi të fshinte lotët nga sytë e saj. - Por..., - vazhdoi Agapinosi, - mendoj se mungon diçka...

Evgjenia dhe Klelia e panë si u zhduk për pak kohë në bibliotekë, dhe më pas u kthye duke mbajtur në dorë një kuti të vogël.

Klelia po e shihte me habi.

- Baba, ç'është ajo? - e pyeti me sytë të ngulur te kutia.

- Është diçka që ia kisha dhuruar nënës tënde. Erdhi koha që bizhuteritë e saj t'i marrësh ti.

Ai e hapi kutinë, dhe brenda në këllëfin e kadifenjtë gjendej një zinxhir i hollë që mbante një varëse prej diamanti, në formën e pikës së lotit.

Sytë e Klelias u shqyen nga habia.

- Sa e bukur qenka! - tha pa mundur ta prekte.

- Kjo stoli i pëlqente shumë nënës tënde. Ia kisha dhuruar para se të ikja me studime. Ishte një premtim

se do të kthehesha shpejt afër saj... Gjatë kohës që isha me studime ajo nuk e hoqi kurrë nga qafa... Tani është e jotja...

Me duart që i dridheshin, Agapinosi, nxori stolinë dhe ia vari në qafë së bijës. Për një moment mendoj se koha ishte kthyer mbrapsht dhe ishte Luçia ajo që qëndronte para tij, dhe duart e tij po preknin lëkurën e saj të bardhë, por u përmend shumë shpejt. Jo... Ishte vajza e tyre, që priste me padurim që t'i mbërthente zinxhirin, e të shkonte me vrap para pasqyrës veneciane për ta parë.

Një pasthirrmë doli nga buzët e saj dhe iu afrua menjëherë të atit dhe e përqafoi.

- Baba, është kaq e bukur! - i tha e prekur. - Të vjen keq, nëse nuk e heq kurrë? - shtoi ajo dhe pastaj e puthi.

- Jo, bija ime, nuk më vjen keq... Mos e hiq... Ndoshta të sjell dhe ty fatin që të provosh një dashuri të madhe, si ajo që ndamë me mamanë tënde... Një dhe përgjithmonë...

Evgjenia nuk kuptoi nëse ky ishte urim apo mallkim. Por fati ama e dinte ...

Hyrja e Agapinosit në shtëpinë fqinje, shkaktoi habi. Në radhë të parë ishte prezenca e vetë atij, Rikardo Agapinosit, i cili nuk dilte kurrë nga shtëpia e vet, aq më shumë për një ngjarje publike, dhe pastaj ishte bukuria e Klelias. Disa s'e kishin parë kurrë, por ata që kishin njohur çiftin në ditët e tij të lumtura, nuk kishin si të mos habiteshin. Klelia ishte e njëjtë me Luçie Agapinosin. Ngjanin si dy pika uji.

Pavlo ndjeu t'i mblidhej një lëmsh në grykë dhe pa dashur iu mbushën sytë me lot. E dashuronte kaq

shumë sa ndiente dhimbje. E shihte duke folur me nënën e tij dhe nuk kishte forcë të shkonte deri atje. I dukej sikur këmbët ishin rrënjosur në dyshtemenë prej mermeri. Shikimi i saj po e kërkonte dhe, sapo e pa i buzëqeshi, duke e bërë zemrën e tij që të humbiste rrahjet e saj. E pa duke folur me të tjerët dhe pastaj iu afrua me nxitim.

- Mirëmbërëma! - e përshëndeti ajo e gëzuar. - A s'është e mrekullueshme kjo mbrëmje?

- E magjishme..., - iu përgjigj Pavlo dhe nuk nënkuptonte mbrëmjen por vetë atë.

- Shiko ç'më dhuroi babai? - i tregoi ajo diamantin që i varej në qafë. - Ka qenë i nënës sime. Ia kishte dhuruar kur iku me studime. E dashuronte marrëzisht. A s'është shumë i bukur? I thashë që s'do ta heq kurrë.

- E mrekullueshme..., - mundi të thoshte Pavlo, por përsëri nuk nënkuptonte të njëjtën gjë si ajo. Lëkura e qafës së saj, ku prehej stolia, e tërhiqte si magnet. Po vdiste që ta merrte në krahë e ta fuste kokën në flokët e saj, ta mbushte me puthje lëkurën e saj të butë si kadife, që në sytë e tij emetonte një dritë fantastike dhe drithëruese.

- Pavlo, çfarë ke? - e pyeti vajza. - Mos më thuaj që je i sëmure në një mbrëmje si kjo? - iu ankua ajo dhe ai më në fund erdhi në vete.

- Jo, jo shumë mirë ndihem, por, që të jem i singertë... u verbova!

- Prej meje? - qeshi Klelia.

- Po... Je kaq e veçantë sonte...

- Natyrisht! Kam veshur një fustan tepër të shtrenjtë, që ma zgjodhi mamaja jote, kam krehur

flokët dhe... nuk do e besosh! Kam lyer buzët dhe qerpikët! Mamaja jote më mësoi! A s'është fantastike!

Ai ia nguli përsëri vështrimin asaj. Sytë e tij u takuan ëmbël me buzët e saj, ashtu siç ëndërronte të bënin buzët e tij, që në momentin e parë kur e pa.

Por Klelian, një tjetër surprizë do ta çudiste e do ta linte pa zë.

Babai iu afrua dhe i tha me zë të ulët:

- E di që do të jetë gabimi im nëse nuk do të dish...

- Baba, çfarë të mos di?

- Të kërcesh!

Përgjigja e saj ishte një e qeshur e gëzuar.

- Më mësoi Pavllo, - i tha ajo me krenari.

- Atëherë... Do kem nderin?

Klelia pa dorën e tij të zgjatur drejt saj dhe me ndrojtje i dha të sajën. E la ta merrte me vete në pistën e improvizuar nën tingujt e një vals. Në fillim dridhej se mos bënte ndonjë gabim, por më kot shqetësohej. Babai i saj ishte një kërcimtar i mrekullueshëm. Ai e udhëhiqte sipas ritmit në mënyrë të qëndrueshme dhe me delikatesë, dhe asaj për një moment iu duk sikur këmbët nuk shkelnin fare në tokë.

Kush i njihte Rikardon dhe Luçien u panë sy në sy.

- Më duket sikur po përjetoj të kaluarën! - i pëshpëriti një zonjë burrit të saj.

- Ishte çifti më i bukur që kishte pasur ndonjëherë Korfuzi.

- Po, më kujtohen! - iu përgjigj ai, duke tundur kokën me hidhërim. - Dhe kjo ngjashmëri... është gati... të tremb.

Kur mbaroi vallëzimi Rikardo e ktheu vajzën në shoqërinë e Pavllos, i cili po priste në të njëjtin vend, pa lëvizur asnjë centimetër.

- Po ta dorëzoj! - i tha. - Dhe po pres që të krenohem edhe me ju në pistë.

Pavlo mundi të tundte kokën dhe pastaj u kthye nga Klelia e cila po i buzëqeshte.

- Atëherë, më thuaj, isha nxënëse e mirë? - donte të mësonte ajo.

- Ishe e përkryer! - i tha me dashuri në çastin kur po fillonte një tango.

- Po tani? Unë do të të kërkoj të më marrësh të kërcejmë? - e pyeti Klelia.

Pavlo e dinte se nuk mund të kundërshtonte më. Gjatë kohës që i mësonte kërcimin, e kishte mbajtur në krahë dhjetëra herë, por sot... sot të gjitha ishin ndryshe. I zgjati dorën, e cila i dridhej pak, dhe Klelia i buzëqeshi përsëri. E drejtoi për në pistë. Trupi i saj në krahët e tij e dehte, i linte shenja dhe ai e ndiente se këto shenja nuk do t'i iknin kurrë. Do mund t'i mbulonte vetëm me ëndrra, me ëndrra se ndonjë ditë do ta bënte të tijën.

Të ftuarit e kthyen menjëherë vëmendjen te çifti. Pavlo ishte përqendruar te kërcimi dhe Klelia e ndiqte me kënaqësi. Ishin aq të bukur, shkonin aq shumë me njëri-tjetrin, saqë të gjithë pyesnin veten se sa kohë do kalonte që të dëgjonin lajmin e gëzuar të fejesës së tyre, megjithëse ishin shumë të rinj.

Sapo mbaroi vallëzimi, u kthyen në vendet e tyre, por vajza nuk arriti të merrte frymë, të rinjtë, që ishin të ftuar, u vunë në radhë për të kërcyer me të.

Gjatë një pushimi, Klelia, duke iu marrë fryma, u kthye nga Pavlo.

- Më duket se tashmë po më merren mendtë, - i tha me gëzim.

- Je mbretëresha e mbrëmjes! - iu përgjigj ai, duke u përpjekur të gëlltiste xhelozinë që po e gërryente prej orësh.

- Unë dhe Skarlet O'Hara! - u përgjigj ajo. E kishte lexuar vjet kryeveprën e Margaret Miçëll dhe i kishte pëlqyer shumë.

Atë natë, Pavllo, vërtetoi se dy kryeveprat që kishte lexuar e rilexuar Klelia, kishin një pikë të përbashkët, trekëndëshin shekullor të dashurisë midis një gruaje dhe dy burrave. E largoi nga mendja se ky do ishte dhe fati i tij, që t'i duhej t'i kërkonte të njëjtën gjë edhe të dashurës së tij.

Ndërrimi i viteve shkaktoi entuziazëm te të pranishmit. Nata, që ishte aq e butë, nuk i prishi planet e Anës, për ta pritur Vitin e Ri në kopsht, duke pirë shampanjë dhe duke hedhur fishekzjarrë, të cilat i kishte sjellë i shoqi nga Italia. Klelia, e kapur pas krahut të Pavllos, me vështrimin të ngulur në qiell, dhe me fytyrën e saj që merrte dritë nga nata, e cila ishte bërë si një ditë shumëgjyreshe, nuk mund të mos dallonte se djali përkrah saj, shihte vetëm atë. E kapi disa minuta më vonë tek po e shihte dhe vështrimi i saj, për herë të parë, u magjeps nga vështrimi i tij.

- Vit të mbarë, Klelia..., - i uroi ai ngadalë.

Logjika e tij e ndërpreu drejtimin që kishin marrë buzët, drejt buzëve të saj dhe përfundoi duke i dhënë vetëm një të puthur në faqe. Por, Klelia, e përqafoi fort dhe puthjet e saj ishin të forta... aq të forta sa tregonin qartë qëllimet, por dhe ndjenjat e saj miqësore. Vetëm ato.

- Pavllo, Gëzuar Vitin e Ri! T'u realizofshin dëshirat!

U ndje i dobët që shqiptoi qetësisht vetëm një “faleminderit”, në vend që t’i hapte zemrën, e cila rrihte aq fort për vetë atë.

Gjatë vitit që hyri nuk ndodhi asgjë e re. Klelia e kalonte kohën midis shtëpisë së tij dhe shtëpisë së saj, ndërsa Evgjenia ndiqte me interes, por dhe me shqetësim, se si do të përfundonte kjo lidhje. Pavlo e tregonte qartë se çfarë ndiente dhe e kishin kuptuar të gjithë, përveç vetë të zonjës. Vendosi t’i fliste, por Klelia ia preu shkurt që në çastin e parë.

- Evgjeni, mendoj se imagjinata jote i ka kaluar caqet. Po pse ngul këmbë që Pavlo është i dashuruar me mua?

- Sepse është, zemra ime. Të sheh dhe shkrihet i tëri. Dhe habitem si nuk e ke kuptuar?

- Po si ta kuptoj, diçka që nuk ekziston? Kemi kaq vjet, që jemi çdo ditë bashkë dhe asnjëherë nuk më dha shkak. Asnjëherë sjellja e tij nuk më bëri të kuptoj se më dashuron. Dua të them të më dashurojë kështu si më thua ti. Nëse ishte i dashuruar, nuk do ishte përpjekur të bënte diçka? Nuk do përpiquej të paktën të më puthte?

- Para së gjithash je e vogël, e pastaj, miqësia juaj familjare, e pengon të sillet... domethënë të mos sillet ashtu siç duhet!

- Tani po më flet sikur jetojmë në kohën kur u shkrua *Dalja në sipërfaqe*, Evgjeni, në ditët tona, një i ri që është i dashuruar, dhe i ka të gjitha mundësitë...e, njërën nga ato do ta shfrytëzonte! Jo... jo, e ke gabim! Pavlo më sheh ashtu si e shoh edhe unë! Si shoqe.

- Po ti? Do dëshiroje të ishte ndryshe? - donte të merrte vesh grua.

Klelia e pa e menduar.

- Nuk e di..., - u përgjigj më në fund, por ngadalë, sikur po fliste me vete. - Mendoj se parapëlqej që gjërat të jenë kështu siç janë. E dua, por jo ashtu si shkruhet nëpër romane.

- Romanet, zemra ime, janë shkruar e zeza mbi të bardhë. Me zemrën, ndryshon puna.

- Jo kaq shumë! Á s'duhej të më rrihte zemra kur e shoh? Nuk duhet të drithërohem kur më prek? Ta mendoj vazhdimisht? Të çmendem për të qenë në krahët e tij? Për një puthje të tijën? Si ndiheshe ti para se të martoheshe me Spiron? Si roman ishte dhe ajo e juaja?

- Jo. Me Spiron çdo gjë ishte si... Rilindje! - në fytyrën e gruas u pikturuan të gjitha ngjyrat e dashurisë.

- E sheh? E dua Pavllon, nuk them. Nuk mund ta imagjinoj jetën time pa atë pranë, por e dua si shok.

Evgjenia ndryshoi temën e bisedës. Nuk do nxirrte asgjë në dritë nëse do të vazhdonte akoma t'i bënte presion, ishte më se e dukshme se vogëlushja e saj nuk ushqente ndjenja pasioni për djaloshin e dashuruar. Por shqetësimi i saj nuk u zvogëlua... Përkundrazi...

Kur Klelia mbushi shtatëmbëdhjetë vjeç, Agapinosi për herë të parë e festoi ditëlindjen e saj me shkëlqim të madh. Pas kaq vitesh, shtëpia, hapi dyert e saj, u ndriçua e tëra dhe Ana mori përsipër organizimin e darkës festive. Ishte e pranishme gjithë shtresa e lartë e Korfuzit. Klelia shkëlqente, dhe pranë saj qëndronte

i ati, i cili krenohej me të, ndërsa Pavllo ishte bërë tashmë hije e vetvetes. Mamaja e tij, pasditen e asaj dite, kishte diskutuar gjatë me të, diskutim që edhe vetë Pavllo do preferonte ta kishte shmangur. Por kur Ana Llagunari donte një gjë, asnjë nuk mund ta pengonte për ta arritur.

Kishte hyrë në sallon, ku Pavllo po përpiquej të studionte disa partitura, dhe për herë të parë notat i ngjanin me simbole të panjohura të një shkrimi të rrallë.

- Pavllo, mendoj se ne të dy duhet të flasim! - i deklaroi ajo dhe u ul përballë tij.

- Mama, po studioj..., - u mundua ta shmangë ai.

Por Ana mblodhi buzët e mërzitur.

- Mund të studiosh edhe më vonë! Gjithashtu, mesa kuptova, e vetmja gjë që mund të bësh është të shohësh notat e të mendosh Klelian!

Vetëm përmendja e emrit të saj e bëri të dilte nga qetësia që donte të mbante.

- Ç'lidhje ka Klelia me këtë?

- Nuk ka, por do të doje të kishte dhe veçanërisht me ty! Mos u përpiq të më kundërshtosh apo të më rendisësh justifikime qesharake! Të njoh shumë mirë dhe di gjithashtu se që në momentin e parë që e pe nuk e pe si shoqe!

- Mama, ç'janë këto që thua tani?

- Pavllo... ti e dashuron dhe kjo nuk është gjë e keqe. Por mos u sill sikur ke bërë krim. Pastaj, kohët e fundit të shoh të shqetësuar. I the gjë?

- Çfarë t'i them?

- Që e dashuron. Çfarë tjetër?

- Mama... por...

- Pavllo, vajza është e vogël dhe nuk të thashë të sillesh në një mënyrë që nuk i përshtatet moshës së saj, por ajo duhet ta dijë se ç'ndien ti për të. Ndoshta dhe ajo...

- Ajo më sheh si shok... si vëlla!

- Pse je kaq i sigurt? Është e vogël dhe e padjallëzuar! Ndoshta nuk di ta shprehë atë që ndien!

- Mama, më vjen keq nëse po ta prish ëndrrën, por nuk është kështu! Një vajzë, aq më tepër si Klelia, do dinte të më thoshte se më sheh në një mënyrë tjetër. Sytë e saj, kur më shohin, janë të mbushur me admirim...

- E sheh? - u nxitua ta ndërpriste e ëma.

- Po, admirim! Por jo për një burrë! Jo për të dashurin! Por vetëm për Pavllon... shokun e saj... vëllain e saj... E kuptove! Mama, jam i vetëm në ato që ndiej! I vetëm!

Pavllo mbylli me forcë kapakun e pianos dhe zhurma e bëri Anën të tundej nga vendi. Nxitoi ta përqaftonte, ta pushtonte me duart e saj, e t'ia merrte dhimbjen që i copëtonte shpirtin. Pavllo sikur u qetësua pak, por pastaj, lotët i dogjën sytë dhe i la të rridhnin lirshëm, duke lagur duart e Anës e cila bëri të njëjtën gjë.

- Mama, e dashuroj... e dashuroj marrëzisht. Netëve nuk mund të fle, sytë e saj më torturojnë... Fytyra e saj më ndjek pas... e qeshura e saj mbizotëron në ëndrrat e mia,... ëndrra... Që janë të mbushura me të... Vetëm në ëndrra ajo është e imja... Plotësisht... Më puth, më flet me fjalë, fjalë të cilat çmendem t'i dëgjoj edhe kur jam i zgjuar. Për hatër të saj mund të bëj gjithçka... vetëm të më lejonte.

- Pavllo... nuk dua të të mërzis... por këto gjëra nuk bëhen me zor. Nëse nuk të dashuron, ndoshta do të të duhet ta harrosh...

- Mama, po më kërkon të mos marr frymë? Nuk mund të jetoj pa Klelian... Nuk e kupton?

Ana u tremb. Për herë të parë konstatoi madhësinë dhe intensitetin e ndjenjave të djalit të saj. Në darkë, në ditëlindjen e Klelias, kuptoi se po të mos bënte diçka, Pavllo rrezikohej. E pa tek e mbante në krahë dhe kërcente, dhe dukej sikur fluturonte në parajsë, dhe kur ajo kërcente në krahët e ndonjë tjetri, sikur e përpinte ferri. E shihte se si gjallërohej sa herë shihte sytë e saj që nguleshin te sytë e tij, dhe se si zhdukej në shkretëtirë kur ajo shikonte diku tjetër. Jo, kjo nuk ishte një dashuri e zakonshme, ashtu siç mendoi në fillim. Duhej patjetër të bënte diçka, bile sa më shpejt. Po atë natë, kur u kthyen në shtëpi, nuk e la Kostandinin të shtrihej.

- Duhet të flasim! - i tha papritur dhe toni i saj i ashpër, e trembi Kostandinin.

- Ana, ç'po ndodh? Diçka nuk shkon mirë... apo s'është kështu?

- Po..., bëhet fjalë për Pavllon. Kostandin, ai është i dashuruar marrëzisht pas Klelias!

- Këtë s'ishte nevoja të ma thoshe! Duket qartë!

- Dhe diçka tjetër duket qartë! Që vajza nuk i përgjigjet ndjenjave të djalit tonë! Pavllo po bëhet çdo ditë e më keq! Duhet të bëjmë diçka!

Ana mendonte se duhej të luftonte me të shoqin për ta bindur që ta dërgonin të birin diku larg për njëfarë kohe, por u çudit kur vërtetoi se Kostandini ndante të njëjtat mendime me të.

- Domethënë je dakord? - pyeti e çuditur.
- Pse... qorr jam? Nuk shoh? Ai ishte gëzimi i jetës për ne dhe tani një buzëqeshje e tij është e rrallë si antikuar! Natyrisht përveçse kur i flet ajo!
- Kostandin, nuk e ka ajo fajin!
- Pse thashë unë që e ka ajo fajin? Këto gjëra o vijnë, o s'vijnë! Por edhe ne duhet ta ndihmojmë djalin tonë! Ana e përqafoi e lehtësuar.
- Kisha frikë se nuk do e kuptoje! - iu hap ajo.
- Edhe po të mos e kuptoja, zemra ime, mësova të kem besim tek ato që ti mendon dhe tek instinktët e tua!
- Problemi është se si ta bindim atë që të largohet!
- Do merrem unë me të! Do përpiqem ta rregulloj ta çojmë në Francë për t'u perfeksionuar në piano. Atje është një pedagog, të cilin Pavllo e adhuron. Do t'i shkruaj dhe do t'i kërkoj që t'ia bëjë ai propozimin... Të duket si një iniciativë e tij. Pavllo do gëzohet kaq shumë, sa do t'i vijë zor që ta kundërshtojë.
- Ah Kostandin! Je thesar!
- Vetëm se do na ikë...
- S'ka gjë! Përderisa është për të mirën e tij, le të iki! Në Francë do ketë eksperiencë të reja, do ndryshojë ambient! Këtu që e sheh çdo ditë, si mund të shpëtojë nga ndikimi i saj... Pastaj, ndoshta edhe ajo, ngaqë do ta humbasë për pak, do e kuptojë që e dashuron dhe kështu arrijmë në përfundimin e dëshiruar!
- Le të shpresojmë! Sa do doja ta shihja Pavllon të lumtur në krah të një vajze të tillë!
- Edhe unë. Po nuk është në dorën tonë. Është në dorë të Zotit dhe të fatit! Kush prej këtyre të dyve

luajti këtë lojë të keqe, askush s'e dinte. Rezultati ishte i njëjtë...

Çdo gjë u bë siç e kishin parashikuar të dy prindërit.

Pavlo u ndodh në pozitë shumë të vështirë kur lexoi letrën e pedagogut, por ishte e pamundur ta kundërshtonte. Ana ia arriti që të qetësohej vetëm kur e pa t'i shkruante përgjigjen pozitive dhe kur filloi të përgatitej për udhëtim. Momenti kur do ia thoshte Klelias ishte më i vështiri. Vajza e dëgjoji e habitur kur ai i tha se do largohej për të paktën një vit, dhe sytë iu mbushën me lot. Nuk mund t'ia nxinte truri se për një periudhë kaq të gjatë nuk do ishte afër saj, nuk do lexonin së bashku *Daljen në sipërfaqe*, nuk do dilnin shëtitje, nuk do i fliste, nuk do shihte sytë e tij. U hodh mbi të dhe e shtrëngoi fort.

- Mos ik! - i thoshte dhe i thoshte përsëri mes ngashërimeve dhe Pavllos i dukej sikur po shihte ëndërr. E kishte humbur fare. Dhe pak i duhej që ta shkulte zemrën nga gjoksi dhe ta vinte në këmbët e saj. E shtrëngoi dhe ai me pasion pas vetes, u shkri i tëri, u shkërmoq në miliona molekula që të kishte mundësi të futej nën lëkurën e saj, të thithej prej lotëve të saj, të ulej në buzët e saj... Vuri re buzët e saj që po i dridheshin dhe për herë të parë guxoi që t'i prekte me të njëjtin respekt të përzier me frikë që do të prekte diçka të shenjtë. Puthja e tij mbartte gjithë ëmbëlsinë e shpirtit të tij së bashku me dëshpërimin në të cilin kaq vite e kishte zhytur siguria se do të ngelej vetëm një mik i mirë dhe asgjë më tepër.

Klelia për një çast mbeti pa lëvizur, dhe ai arriti të dallonte habinë e saj, por pastaj ajo u lëshua me kërshëri në ndjenjën e panjohur të puthjes së tij. I la

buzët e tij të hulumtonin buzët e saj dhe njëkohësisht përpiqej të kuptonte se çfarë ndjenje i shkaktonte ajo puthje. Nuk ndjeu asnjë drithërimë... asnjë mpirje të ëmbël siç përshkruanin romanet. Kur putheshin, koka e saj nuk u anua majtas e djathtas, zemra e saj nuk i shpeshtoi rrahjet e saj. Megjithatë, ajo që ndiente ishte diçka tjetër, diçka e çuditshme... Pas qepallave të mbyllura, shihte veten e saj se si zhytej në një det të njohur, të ngrohtë, në një det të kaltër e të qetë si ai det ku notonin sirenat e përrallave të Evgjenisë kur e vinte në gjumë. Nuk donte të dilte nga ai det, nuk dëshironte që Pavllo të ndalonte së puthuri...

Buzët e tij lëshuan pa dëshirë buzët e saj, ai kishte mbetur pa frymë, sytë e tij dukej sikur nuk e shihnin.

- Klelia, më fal..., - i pëshpëriti..., - por... por, kam kaq vite që të dashuroj dhe kjo e puthur është e vetmja gjë që guxova të kërkoj... Nëse të ofendova, më fal...

- Më dashuron? - e pyeti ajo ngadalë.

- Shumë... Që ditën e parë që të pashë...

- E pse s'më the kurrë asgjë?

- Sepse ti nuk më dashuron...

- Unë? E si mund ta thuash këtë?

- Zemra ime, e njoh madhësinë e dashurisë tënde, por ndiej edhe formën e saj. Nuk do mund të kërkoja asgjë tjetër. Do ishte e kotë...

- Nuk dua të të humbas...

- Kush të tha se do më humbasësh? Edhe ti po të doje, unë nuk do ta përballoja dot.

- Pavllo, po ikën që të largohesh prej meje? Sepse unë të dua ndryshe?

- Jo... Po iki, sepse m'u dha mundësia të studioj përkrah një njeriu dhe pedagogu të veçantë. Por kështu

si erdhën gjërat, është më mirë të na ndajnë disa qindra kilometra... Derisa të harroj që të mbajta në krahët e mi dhe të putha, pa pasur të drejtën... ndoshta kur të kthehem do më shohësh ndryshe.

- Pavllo, s'kam faj..., - Klelia filloi përsëri të qajë.

- Asnjëherë nuk thashë se ke faj... As unë që të dashurova, s'kam faj...

Ditët e para pa Pavllon, ishin për Klelian si ato ditët pa diell, errësirë, melankoli, dhe një vetmi e pabesueshme. Në fillim, për çdo gjë që i vinte në mend, vraponte t'ia thoshte atij. Por pak para se të kalonte pragun e shtëpisë së tij, kujtohej që ai nuk ishte, dhe kthehej në shtëpi me kokën ulur. Në fillim Evgjenia e pastaj babai i saj, vunë re ndryshimin e saj dhe donin t'i flisnin. Evgjenisë, Klelia nuk i tha asgjë, por para babait të saj një forcë e panjohur ia hapi gojën.

- Nuk e di, baba..., - tha sapo ai filloi bisedën. - Pavllon e dua shumë. Vetëm, se diçka më thotë, se kjo nuk mjafton... diçka mungon... dhe nuk e di se ç'është!

- Kjo nuk është ndonjë gjë e çuditshme! - iu përgjigj ai.

Klelia e pa me habi.

- Nuk është?

- Sigurisht që jo! Klelia, mungon dashuria! Pavllon e do, por nuk je e dashuruar me të.

- Saktë, kështu është! - vështrimi i saj u ndriçua.

- Por ai, është... - përfundoi përsëri me melankoli ajo.

- E ëmbla ime, kjo është një padrejtësi e zakonshme e jetës! Nuk është as i pari as i fundit që dashuron pa kundërpërgjigje. Me kalimin e kohës do ta kuptojë, dhe do të të qëndrojë pranë si mik!

- Baba, nuk jam kaq e sigurt. Edhe për së largu e ndiej që po vuan, por nuk mund të bëj asgjë. Më mungon, por nuk do ishte e ndershme t'i kërkoja të kthehej, përderisa unë pres dikë tjetër...

- Kë?

- Dashurinë, baba! A s'pret atë çdo grua?

- Ke të drejtë zemra ime. Atë... Dhe kur të vijë, nuk do të ketë vend as për mendime dytësore, as hezitime, as pritje! Vetëm uroj që të jetë i duhuri për ty.

- E pse të mos jetë, përderisa do e dashuroj, si nuk do jetë i duhuri. Do jetë tamam për mua.

- Ndonjëherë, ajo që është e duhur për ne, është e gabuar... Dhe një dashuri e gabuar shkatërron, Klelia, zhduk gjithçka...

- Unë kur të dashuroj, do dashuroj atë që do të jetë i duhuri. Do dashuroj atë që do më bëjë të lumtur! Shumë të lumtur!

Foli fort, gati me irritim. Fjalët e saj i mori një fllad i lehtë. Qielli ishte i hapur... dhe fati u mërzit me vetëbesimin e saj. E dënoi... bile shumë ashpër.

Letrën e parë të Pavllos nga padurimi për ta hapur, desh e grisi. Me shkrimin e tij të njohur, në faqet e panumërta, Pavllo i pikturonte asaj Parisin; në faqet e panumërta e shëtiste në monumentet dhe bukuritë e qytetit të magjishëm. Vetëm pak para se ta përfundonte, aty ku germat shtrembëroheshin, guxoi t'i thoshte atë që dëshironte:

...Sa shumë do të doja që tani të ishe pranë meje. Më mungon, dhe pyes veten, a kishte kuptim kjo që bëra, që u largova prej teje? Mungesa jote këtu më mundon më shumë. Mijëra herë vendosa të merrja aeroplanin më të parë e të kthehesha, e po aq herë u pendova, duke ditur se asgjë s'do të ndryshojë. Zemra ime, mos u ndje keq. Nuk ke faj ti. Unë të dashuroj... Ti nuk ke përgjegjësi për asgjë. Është e pamundur që ëndrrat të dalin të vërteta. Dua të dish, se sa herë që sheh hënën, jam unë ai që e ndez... për hatrin tënd... Kur të prek drita e saj, jam unë ai që ëndërron se po të mban në krahët e tij... Puthjen e vetme që shkëmbyem e mbaj si thesarin më të vyer... Mbase ngaqë jam i sigurt se ishte e vetmja gjë që do të marr prej teje... Të dashuroj...

Klelia qau kur lexoi fjalët e tij të fundit. Kështu e gjeti Evgjenia, duke qarë, duke shtrënguar letrën e tij, dhe e keqkuptoi.

- Nëse e vendose, dërgoji një telegram dhe menjëherë do kthehet te ty! - i tha ngadalë.

Klelia e pa me një vështrim sikur donte t'i ankohej.

- Nuk e kupton, qaj se vuan ai, dhe unë... unë nuk mund... Unë nuk mund ta shoh ashtu si do ai që ta shoh! Ndiej dhimbjen dhe zhgënjimin e tij, por s'kam ç'të bëj! Evgjeni, zemra nuk mban me hatër!

- Ke të drejtë, zonja ime. Këto gjëra nuk mund t'i komandos. Por mos dashuron ndonjë tjetër?

- Jo... nuk ka njeri tjetër në këtë mes..., - nxitoi ta thoshte këtë gjë Klelia.

U nxitua dhe fati ta përgënjeshtrojë, të nesërmen... të dielën e parë të nëntorit... në litaninë e Shën Spiridhonit. Aty takoi atë që ishte shkruar për të, fatin e saj.

Evgjenia kishte marrë të ftohtë dhe Spiro gjithashtu.

Që të dy kishin zënë krevatin, duke rënkuar e duke u djersitur nga temperatura, që herë ngrihej dhe herë zbriste. Babai i saj ishte zhytur në një dosje gjyqësore, dhe vërejtjet e tij duhej t'ua dorëzonte patjetër bashkëpunëtorëve të nesërmen.

Dhe ajo vendosi të shkonte në litani, vetëm.

Ishte një ditë e bukur, e denjë për atë festë të madhe të ishullit. Gjithë banorët e Korfuzit kishin dalë nëpër rrugë, kishin veshur rrobat më të mira, ndërsa orkestrat frymore që do shoqëronin epitafin e Shën Spiridhonit, shkëlqenin me veglat e ndritshme muzikore. Uniformat e tyre me ngjyra të ndryshme tregonin dhe shkollën së cilës i përkisnin. Nëpër rrugë kishte me dhjetëra shitës ambulante, që kërkonin vëmendjen e njerëzve, por e dinin se pa mbaruar litania, s'kishin shpresë që besimtarët t'u kushtonin vëmendje. Një heshtje që tregonte sa dhimbje aq edhe respekt, mbizotëroi menjëherë sapo epitafi i Shenjtit u shfaq në hyrje të faltores. Pranë Klelias u gjendën dy shoqet e saj.

- Erdhe më në fund! - i pëshpëriti Aneta.

- Do rrish për kafe në Liston, kur të mbarojë litania?

- e pyeti Anxhela dhe Klelia u buzëqeshi të dyjave, duke pohuar me një lëvizje të kokës.

Më shumë ndiente sytë e tij që ishin ngulur mbi të, sesa i shihte ato... Disa metra prej andej ku qëndronte, një kokë zeshkane ishte e kthyer drejt saj dhe dy sy jeshil kërkonin të takonin sytë e saj. Nuk e kishte parë kurrë më parë. Ishte i panjohur për të, por zemra e saj... ajo dukej sikur e kishte njohur me një mënyrë tjetër. Zemra rrihte fort në gjoksin e saj, dhe sytë e saj nuk mund të shkëputeshin dot nga ai vështrim.

Litania filloi. Turma hyri në mes tyre dhe ajo pa veten e saj duke e kërkuar, derisa vuri re se ai ishte pothuajse ngjitur me të, bashkë me dy zotërinj të tjerë që diçka i kujtonin. Rrëmoi në kujtesën e saj dhe vështrimi iu ndriçua. Njëri ishte avokat... Kishte ardhur njëherë në shtëpinë e saj, sepse do bashkëpunonte me babanë e saj për një çështje. Po i panjohuri, kush do të ishte vallë?

Pas mbarimit të litanisë, bashkë me shoqet shkuan në Liston, ku ishte e pamundur të gjeje tavolinë të lirë. Para se të largoheshin të zhgënjyera për në shtëpitë e tyre, e pa atë tek qëndronte poshtë harqeve së bashku me dy të tjerët, që e shoqëronin në litani. E panë edhe ata dhe avokati, miku i babait të saj, iu afrua duke buzëqeshur.

- Zonjusha Agapinu! Çfarë rastësie! Si është babai?

- Mirë është... Por nuk mundi të vinte sot... kishte një çështje...

- Po, po, e di se ç'ka marrë përsipër. Me sa kuptova, ti dhe shoqet e tua po kërkonit tavolinë...

- Por fatkeqësisht jemi pa fat...

- Jo, pse! Do ishte kënaqësi për mua dhe bashkëpunëtorët e mi, nëse na nderoni duke u ulur bashkë me ne!

- Por..., - bëri të thoshte Klelia.

Avokati e ndërpreu duke buzëqeshur.

- Nuk do pranoj kundërshtime! Rikardo nuk do ma falë kurrë, nëse do marrë vesh që ju takova dhe nuk ju ofrova as një ëmbëlsirë! Ejani, uluni!

Klelia pa dy të tjerat. Ato nuk e dëshironin këtë gjë dhe refuzuan me edukatë. Por ajo, veçse jo... Nxitonte. Donte të merrte vesh se kush ishte i panjohuri. Vajzat u larguan dhe ajo ndoqi Malltezin për në tavolinën e tij.

Prezantimi u bë menjëherë dhe natyrisht e bëri miku i babait të saj.

- Zonjusha Agapinu, vajza e mikut tim Rikardo Agapinos. Zonjushë Klelia, ky është zoti Jani Kavadhia, bashkëpunëtori im, dhe ky zoti Niqifor Dhamaskinos, që tashmë është pjesëtar i zyrës sonë.

Domethënë edhe ky avokat! Enigma ishte zgjidhur. U ul midis tre burrave dhe kërkoi t'i sillnin një pije freskuese. Përnjëherë u kthye nga Niqifori.

- Zoti Dhamaskino, tani keni ardhur në ishull? - e pyeti dhe u gëzua që zëri nuk po i dridhej ashtu siç po i dridhej zemra e saj.

- Këtu u linda, zonjushë... Mamaja ime është nga Argjirades ndërsa babai nga Lefkimi. Aty u linda dhe unë. Por isha larguar disa vjet për studime.

- Dhe tani u kthyet?

- Niqifori, - e mori fjalën Malltezi, - është një nga avokatët e rinj më të mirë! Është një gëzim i madh që arritëm ta kemi pjesëtar të zyrës sonë! Po ju zonjushë tani që po mbaroni shkollën, me çfarë do të merreni? A s'jeni në vit të fundit?

- Po, por nuk kam vendosur akoma, - u përgjigj ngadalë Klelia dhe për herë të parë e kuptoi se nuk kishte menduar asnjëherë të studionte më tej, as me babanë e saj nuk e kishte diskutuar ndonjëherë këtë gjë.

Vëmendja e saj u kthye në diskutimin që po bënte shoqëria e saj.

- Po s'është e mundur! - protestonte tani Malltezi dhe Niqifori buzëqeshi.

- Megjithatë, i dashuri im, vërtet nuk krenohem, por pas kaq vitesh mungesë Korfuzi është i panjohur tashmë për mua. U largova menjëherë sa mbarova shkollën, dhe nuk u ktheva më, përveçse tani. Kur isha i vogël, të them të vërtetën, nuk kisha ndonjë dëshirë të madhe për turizëm! Më interesonin gjëra të tjera.

- Atëherë, duhet të përpiqesh që më së fundi të njohësh vendlindjen tënde të bukur!

- Kjo varet nga ju, dhe nga punët që do më ngarkoni! - buzëqeshi përsëri Niqifori dhe Klelia lëvizin nga vendi duke bërë një përpjekje për të kontrolluar veten.

Çdo buzëqeshje e tij e bënte zemrën e saj që të kërcente me një melodi të vetën. Prania e tij e kishte magjepsur dhe u frikësua se mos e vinin re të tjerët dhe atëherë pozicioni i saj do vështirësohej. Përfundoi me shpejtësi atë që i kishte mbetur në gotë dhe u ngrit. Burrat bënë të njëjtën gjë pothuajse menjëherë.

- Të më falni që po largohem kaq shpejt, - u justifikua duke buzëqeshur, - por nuk i thashë babait që do të vonohem dhe ai do shqetësohet. Ju faleminderit për qerasjen dhe për mikpritjen në tavolinën tuaj...

Pastaj u kthye nga ai dhe i zgjati dorën. Kishte nevojë të ndiente prekjen e tij.

- Zoti Dhamaskino, u gëzova shumë që u njohëm... tani që do banoni në Korfuz, ndoshta mund të takohemi sërish...

Dora e tij u zgjat dhe takoi dorën e saj. Për Klelian agoi menjëherë një diell vezullues, më vezullues se ai që ngrohte ditën, e dogji, e shkriu fare. Shtrëngimi i duarve përfundoi brenda kufijve që lejonte formaliteti dhe edukata, dhe Klelia u kthye nga dy të tjerët dhe bëri të njëjtën gjë. Tani nxitonte... Nxitonte të ikte, të largohej nga ajo ndjenjë që s'e kishte ndier kurrë më parë. Eci me hapa të shpejtë, por tronditja nuk donte t'i largohej. Ndjenja e pëllëmbës së tij në momentin që preku pëllëmbën e saj, e shoqëroi deri në shtëpi.

Babai po e priste që të hanin së bashku.

- U vonove, apo kështu m'u duk mua? - e pyeti ai dhe pastaj, duke e parë më me vëmendje, shikimi i tij u mbush me shqetësim. - Çfarë ke? Nuk ndihesh mirë? Mos ta ngjitën gripin Evgjenia me Spiron?

- Shumë mirë jam, - nxitoi të përgjigjej ajo, dhe e hutuar e puthi në faqe.

- Shumë e skuqur më dukesh!

- Eca shpejt. Është gjithë ajo rrugë që nga Listoni. E di... takova një mikun tënd... Më ofroi dhe një pije freskuese.

- Kë?

- Malltezin! Ishte me dy kolegë të tij, dhe sa më pa...

- Xhorxhi, si gjithmonë xhentil! Nuk të çmendi me sjelljen e tij prej aristokrati?

- Po, e vërteta është se sillet thua se jetojmë në vitet 1800!

- Kështu është ai! Jeton në tjetër epokë! Me kë ishte?

- Me një që e quanin, Kavadhia...

- A, po! Janin! Edhe ai po me mendësinë e viteve 1800! Po mirë moj vajzë, nuk gjete ndonjë të moshës tënde që të rrije?

- Baba, nuk kishte tavolina! Bile po bëhesha gati të ikja, kur më pa Malltezi...

- Dhe të tregoi histori?

- Ishte... ishte dhe një tjetër bashkë me ta... njëfarë Niqifor Dhamaskino... E njeh?

- A, po! Bashkëpunëtori i ri i mikut tim! Me studime të spikatura, megjithëse i ri në moshë.

- Po... edhe mua i ri m'u duk...

- Megjithëse është vetëm tridhjetë e dy vjeç, ka bërë emër në qarqet juridike. Çuditem, se pse pranoi të punojë këtu dhe jo në Athinë. Nejsje! Më njoftuan se dreka është gati... shkojmë?

E ndoqi të atin drejt tavolinës së ngrënies, ndërkohë që bëri përpjekje të shumta që të kapërdinte të paktën një kafshatë. E vetmja gjë që do të donte në atë moment ishte që të mbaronte ajo torturë e bisedës së këndshme në tavolinë dhe të mbetej vetëm. Të mbyllej në dhomën e saj dhe të jetonte moment pas momenti takimin me të, dhe kryesisht, ndjenjën që i shkaktoi prekja e dorës së tij...

U shtri në krevatin e saj, pasi më parë largoi dritën e diellit që e shqetësonte, duke mbyllur të gjitha grilat, dhe e zhyti dhomën e saj në hijen e mesditës së vonë. Me shikimin të ngulur në tavan, kishte

mundësi ta përfytyronte qartë dhe pa ndërprerje. Sytë e tij, buzëqeshjen e tij. Dhe befasi ndjeu se gjithçka i shkaktonte dhimbje... Ndiente se diçka e madhe i kishte ndodhur, diçka që i kishte ndryshuar universin. Asgjë s'do ishte më njësoj si më parë. Pa ndonjë arsye ndjeu lot në sytë e saj, lot që digjnin, lot që rridhnin dhe linin shenjë. Donte ta shihte përsëri, t'i fliste... të dëgjonte zërin e tij... vetëm ajo... U turpërua kur kuptoi se midis "dëshirave" të saj ishte dhe puthja e tij...

U ngrit nga krevati e zemëruar dhe fshiu lotët me pëllëmbën e dorës, si fëmijë i inatosur. Ç'e kishte gjetur? Ç'punë kishte ajo me një burrë kaq më të madh se ajo në moshë? Po Pavllo? Si e harronte Pavllon dhe gjithë dashurinë e saj për të e aq më tepër dashurinë e tij?

Ndezi abazhurin në tryezën e saj dhe u ul t'i shkruante:

Pavllo im i dashur...

Më mungon jashtë mase. Sot vajta në litani dhe isha vetëm. E mban mend? Qëkur u njohëm, çdo vit në këtë ditë kemi qenë bashkë. Besoja se do vije për festa, por mamaja jote më tha se do të vijnë ata në Francë për Krishtlindje. Më kujtohet se sa e bukur ishte vjet dita kur pritëm Vitin e Ri... ndërsa sivjet... do jem vetëm dhe do të të mendoj...

Ndaloi papritur dhe e grisi letrën me inat. Ç'po bënte tani? Pse i jepte shpresa të kota një njeriu që vuante? Si mund të ishte kaq e keqe? Sot, për asnjë minutë s'e kishte pasur mendjen tek ai. Gjatë gjithë

kohës mendonte Niqiforin, që në çastin e parë që e pa... Dhe diçka i thoshte se ky ishte vetëm fillimi...

Takimi tjetër me të nuk vonoi por edhe ky takim ishte i rastësishëm ashtu si i pari. Atë ditë binte shumë shi, dhe në shkollë i kishin ndezur dritat që në mëngjes. Një kohë e tillë e mërziste. Nëse do ishte në dorën e saj, nuk do ngrihej fare nga krevati, por Evgjenia ishte shumë e prerë në këtë pikë. Klelia duhej të mbaronte shkollën patjetër dhe nëse nuk ishte e sëmurë, asnjë mungesë nuk kishte justifikim. E ngriti me zor nga krevati dhe, me gjithë pengesat dhe vonesat që bënte vetë Klelia, ia doli që vajza të mos e humbiste autobusin e shkollës. Po nuk ndodhi e njëjta gjë dhe në kthim. Një pengesë në momentin e fundit, dhe Klelia e humbi autobusin. Bashkë me shiun që vallëzonte në ritmin e tij dhe i ngjante një perdeje të cilën e tundte një fllad i lehtë, u gjend në hyrje të shkollës, e vetme dhe duke pyetur veten se si do arrinte deri në shtëpi. Makina që ndaloi para saj i ngriti nervat, se e spërkati, por shoferi i saj nuk ishte i panjohur..

- Zonjusha Agapinu! - Niqifori kishte dalë nga makina, dhe iu afrua duke hapur një çadër të madhe. Ajo ishte bërë qullë. - Ç'bëni këtu? - e pyeti dhe nxitoi ta fuste në çadër.

- Më iku autobusi i shkollës! - i shpjegoi ajo e hutuar.

- Si të iku?

- U ktheva në klasë se kisha harruar diçka dhe... më harruan! - iu përgjigj ajo dhe po në atë moment pyeti veten se ç'kishte pësuar dëgjimi i saj. Gjithçka, edhe vetë zërin e saj, i dëgjonte sikur i vinin nga larg.

- Kjo do të thotë, fat i keq, dhe aq më tepër me një kohë të tillë me shi! Ejani! Do t'ju çoj unë në shtëpi!

- Ju?

- Po! Jeni bërë qullë dhe shiu nuk ka ndërmend të pushojë. Nuk mund të shkoni me këmbë! Ejani!

E ndoqi si e hipnotizuar dhe u ul në krah të tij. Në makinë ishte ngrohtë.

- Kam frikë se do t'ju lag ndenjësen! - i tha kur ai po nisej.

- Nuk pëson gjë..., - tha Niqifori. - Por ty ndoshta të pret një e ftohur e mirë. Nuk të vjen keq nëse nuk i drejtohemi njëri-tjetrit në shumës? - plotësoi ai dhe i hodhi një vështrim vjedhurazi. - Është e lodhshme kjo gjë në kohën tonë... Apo s'je dakord?

- Kështu mendoj edhe unë...

Pauza që u krijua e bezdiste, nuk gjente një temë që të fillonte një diskutim të hairit.

Ai u tregua më i shkathët.

- Domethënë atë shkollë ndjek? - tha dhe ajo nxitoi të pohonte me kokë. - U duhet bërë një vërejtje e rëndë, që të harruan! Në një kolegji kaq të shtrenjtë, nuk lejohen të tilla gabime! - shtoi ai.

- Edhe unë kam faj... Hipa në autobus e pastaj u kujtova që kisha harruar dy libra në klasë dhe zbrita që t'i merrja, por pa më parë shoferi...

Përsëri heshtje, dhe Klelia pyeste veten se pse po merreshin kaq shumë me gjëra të kota.

- Përfundimisht, çfarë vendose të bësh me jetën tënde? - e pyeti përsëri.

"Të jem me ty...", - këtë donte t'i thoshte, por buzët e saj mbetën të palëvizura. Ai po parkonte në anë të rrugës dhe ajo e pa me çudi.

- Pse ndaluam? - e pyeti.

- Se për pak do arrijmë, dhe më duket sikur më ke frikë... Dua të di arsyen..., - i tha me të butë.

- Nuk të kam frikë! - deklaroi ajo, por pastaj pushoi përsëri e pasigurt.

- Klelia..., - shqiptimi i emrit të saj në buzët e tij ngjante me një këngë, me muzikë, - Klelia, unë dua të bëhemi miq...

- Miq? - zhgënjim ishte ai që ndihej në zërin e saj? I hodhi një vështrim dhe nxitoi që të ndreqte përshtypjet që kishte lënë tek ai. - Po ne sapo u njohëm! Që dy njerëz të bëhen miq duhet kohë...

- Dhe ne nuk e kemi? - e pyeti. - Vetëm nëse nuk do ti, nëse mendon se jam shumë i madh për të qenë miku yt.

- Nuk është kjo...

- Atëherë çfarë na pengon? Le të fillojmë që tani. Kur mund të takohemi përsëri?

- Nuk është e lehtë... Dua të them... kam shkollë, ti ke punë.

- Dëshiron të bëjmë një shëtitje të shtunën në drekë? Si thua sikur të më shoqëroje të vizitoja Akilion? E beson se nuk kam shkuar ta shoh?

- Në Akilio? - asaj i dukej si shaka që një banor i Korfuzit të mos kishte vizituar pallatin e perandoreshës Elisabeta.

- Po. Si thua? Do të shkojmë bashkë?

Si mund t'i thoshte "jo", përderisa ishte e gatshme ta ndiqte gjithandej e përgjithmonë. Ishte e dashuruar, dhe tashmë këtë gjë e dinte.

Evgjenia kur e pa të hynte duke kulluar, filloi të bërtiste.

- Ç'është kjo gjendje? Zemra ime, si u lage kaq shumë?

E ngjiti në dhomën e saj dhe kur po e ndihmonte që të ndërrohej, dëgjoji dhe historinë se si humbi autobusin dhe natyrisht dhe atë të Niqiforit, se si u njohën në Liston dhe për takimin e sotshëm. Klelia, që në momentin e parë që filloi të fliste për të, e kuptoi se ishte punë sekondash që Evgjenia të kuptonte se qetësia në zërin e saj ishte e shtirur. Kur vajza po vishte fustanin, sytë e gruas u ngulën te sytë e saj.

- Klelia..., - vetëm kaq arriti të thoshte.

- Evgjeni, mos thuaj asnjë fjalë, - iu lut vajza.

- Si të mos them? Si të pushoj, kur e shoh të pikturuar në sytë e tu, pas çdo fjale që thua? E dashura ime, magji të bëri?

- Nuk e di a është magji, apo vetëm... magji! Jam e dashuruar!

- Si kështu? Papritur e pakujtuar?

- Pse si bëhen këto gjëra? Duhet menduar?

- Kur flasim për një burrë tridhjetedyvjeçar edhe duhet menduar, edhe duhet pasur kujdes, zemra ime! Je e vogël akoma për histori të tilla!

- Por kur ishte fjala për Pavllon, nuk thoshe të njëjtat fjalë?

- Pavllo, qoftë mirë aty ku është, kishte afërsisht moshën tënde, zonja ime! Dhe për më tepër, ishte i dashuruar me ty!

- E ku e di ti që s'do më dashurojë dhe Niqifori? Pastaj, përderisa më propozoi të dalim shëtitje, atëherë i pëlqej!

- Klelia, tjetër gjë njëra, e tjetër gjë tjetra!

- Sidoqoftë unë të shtunën do shkoj në Akilio! Evgjeni, jam shumë e lumtur! Po fluturoj, e kupton?

- E shoh zemra ime... E shoh dhe dridhem...

Ditët deri të shtunën i dukeshin sikur nuk kalonin, dhe Klelia i numëronte, bashkë me orët e me minutat. Sa më shumë afrohej takimi, aq më shumë shtohej nervozizmi i saj. Evgjenia e ndiqte me vështrim vigjilent se si vishte një gjë dhe e hiqte dhe vishte tjetër, derisa të mbetej e kënaqur, dhe mblodhi buzët, kur pa vogëlushen e saj të bënte tualet me shumë kujdes. E kishte mbajtur të fshehtë nga Agapinosi, ashtu siç i ishte lutur Klelia. Por, në momentin kur e pa që po largohej e gëzuar, u pendua për premtimin e bërë, por tashmë ishte vonë. Por edhe moti, ashtu siç ishte i zyrtë, iu duk shenjë e keqe. Re të zeza, diell i fshehur dhe një shi që mbetej në tentativë në vend që të binte me forcë dhe të anulonte takimin.

Tri orë që u vonua Klelia, po aq bëri dhe Evgjenia që të ulej.

- I hëngre dyshemetë, moj grua! - e ngacmoi i shoqi. Dhe ajo që donte të shfrynte diku, gjeti rastin.

- Po, po na cakton ti tani edhe orën kur do ulemi. Nuk të mjafton që na komandon për çdo gjë, do na komandosh dhe këmbët tani. Një jetë të tërë, që kur u martuam, jep mendim për çdo gjë! Ç' do ha, ç' do pi, ç' do vesh, nëse do dal, ku do shkoj! Tani të shqetëson edhe fakti se sa eci!

- Evgjeni, ç'të gjeti? Kur të kam thënë unë ç' do hash e ç' do pish, por edhe nëse të kam thënë, kur më ke dëgjuar mua? - protestoi ai. - Më pas pa sytë e saj dhe e kuptoi. - Pa më thuaj! Ç'ka ndodhur përsëri me vajzën tonë dhe je gati për sherr?

I papërmbajtur, ankthi u derdh nga buzët e saj. Ia transmetoi të gjitha ato që dinte dhe pastaj përfundoi duke qarë.

- Po ai, ç'punë ka me një vajzë të vogël? Humbën femrat që i përshtaten moshës së tij, që të shkojë e të nxjerrë sytë me to? Vogëlushen tonë gjeti që të dashurojë?

- Evgjëni, po nxitohesh... Njeriu...

- Cili njeri! Ai është njeri i ulët! Përderisa e di që ajo as shkollën s'ka mbaruar akoma, ç'do që rri me të dhe e çon nëpër shkretëtira?

- Në cilat shkretëtira, moj grua? Në Akilio vajtën, aty ka plot njerëz. Apo mendon se ky, Dhamaskinoi, do ishte në gjendje që të largonte prej andej edhe kazononë në mënyrë që të rrinte vetëm me vajzën tonë?

- Po këto pse i thua tani? Që të m'i ngresh nervat më shumë? Kaq orë që po vonohen, vetëm Akilion vizituan?

- Mund të kenë shkuar për të ngrënë dhe ndonjë ëmbëlsirë.

- Kjo më shqetëson... Ëmbëlsirat dhe... shurupet.

Ndërkohë Klelia po lutej me gjithë shpirt që të mos binte shi. Arritën në Akilio pak pas orës tre të drekës.

Niqifori shihte përreth me kureshtje.

- Që të jem i singertë, - i tha, - nuk prisja ta gjeja në këtë gjendje kaq të mirë! E imagjinoja se do ishte rrënojë.

- Dhe ashtu do ishte, nëse nuk do ia ndryshonte fatin kazinoja, që ndodhet në katin e sipërm, - iu përgjigj Klelia. E kishte të lehtë të fliste për tema që nuk e elektrizonin atmosferën, për këtë arsye

vazhdonte të fliste me qetësi. - Ky pallat përballoi çdo provë dhe vështirësi, sa në Luftën e Parë po aq edhe në Luftën e Dytë Botërore. Në atë kohë u përdor nga pushtuesit si bazë ushtarake dhe spital dhe fatkeqësisht u plaçkit. Pas çlirimit, u përdor si shkollë fillore, politeknium, institucion mbretëror e deri në ambient lojërash për fëmijë. Siç e kupton u kthye në gërmadhë dhe administrata greke ia dhe me qira një shoqërie gjermane me emrin *Kazino Greke* për 20 vjet. U rikonstruktua, dhe presidenti i shoqërisë mblodhi shumë nga objektet që ishin shpërndarë. Kështu u bë kati i parë, muzeu që do shohim tani, ndërsa dy katet e tjera funksionojnë si kazino...

- Me sa duket ditke shumë për Akilion..., - Niqifori dukej i impresionuar nga njohuritë e saj.

- Është një vend që e dua shumë. Edhe mua, edhe babait tim na pëlqen të studiojmë historinë e vendit tonë, dhe veçanërisht të Korfuzit...

- Me sa duket, je e vetmja që mund të ma mësosh ishullin tim që nga fillimi! - përfundoi duke buzëqeshur.

Do të donte t'i thoshte që të mos buzëqeshte, sepse çdo buzëqeshje e tij trondiste qetësinë e saj tashmë të prishur. Nxitoi ta ndiqte në pjesën e brendshme të pallatit, aty ku do habiteshin duke parë zbukurimet me një bukuri të veçantë. Klelias i dukej sikur të gjitha këto bukuri po i shihte për herë të parë, po i shihte nëpërmjet syve të tij, të cilat ishin hapur tej mase nga kënaqësia, duke shpërndarë ndriçime të gjelbra në fytyrën e tij. Niqifori u harrua duke parë sallën pranë shkallëve, e cila ishte tej mase e bukur dhe perandoresha e quante "shkalla e perëndive".

Në atë kat, duke parë me shumë vëmendje afreskun gjigant, që përshkruante në mënyrë alegorike katër stinët e vitit, ai u pengua dhe gati sa nuk u rrëzua.

Vazhduan vizitën e tyre pa u nxituar, i vizituan të gjitha ambientet dhe u habitën duke admiruar bukurinë e tyre. Niqifori i studioi me kujdes të gjitha portretet e perandoreshës, sendet e saj personale, ndërsa përbri tij Klelia i fliste vazhdimisht për to, duke i transmetuar njohuritë e saj te dëgjuesi. Në vazhdim dolën në kopsht. Dielli nuk donte t'u buzëqeshte, dhe për më tepër pas pak do të perëndonte, ashtu siç bënte çdo natë. Klelia vazhdoi shpjegimin, por pak me nxitim, se kishin kaluar shumë orë dhe e dinte që Evgjenia në shtëpi do ishte shqetësuar.

Niqifori u çudit nga ky ndryshim i saj i menjëhershëm.

- Çfarë ke, ndodhi gjë? - e pyeti. - U mërzite gjë?

- Jo... jo? Këtu brenda nuk do mërzitesha kurrë, por në shtëpi do jenë shqetësuar...

I kishin parë të gjitha statujat, edhe atë që asaj i pëlqente më shumë, atë që tregonte Akilin në çastet e tij të fundit. Dhe tani gjendeshin duke parë detin poshtë vështrimit të Akilit, të Akilit "tjetër", të pushtuesit, atij për të cilin Kaizeri, pronari i mëvonshëm i Akileos, kishte urdhëruar ta transformonin artistikisht, sepse nuk i pëlqente që të kishte në oborrin e vilës së tij statujën e një heroi në prag të vdekjes. Klelia i hodhi detit një vështrim melankolik, i cili poshtë errësirës që kishte filluar të binte, bëhej kërcënues. Retë nuk po e mbanin dot peshën e tyre dhe ishin përkulur, dukeshin sikur po çlodheshin mbi buzët e valëve të buta. Ajo shfryu pa dashje dhe Niqifori iu afrua dhe më shumë.

- Ç'po ndodh? Kontesha na u bë melankolike?

- Si më quajte? - e pyeti dhe vështrimi i saj fshihte një panik të pashpjegueshëm.

- Mos më thuaj që u preke? Por kështu si po e shihje detin, nuk e di pse, por më kujtove personazhin e Ksenopulos... Ndoshta edhe nga emri yt... Është i rrallë, por kush e ka lexuar Ksenopulon, njeh dhe *Daljen në sipërfaqe* të tij...

- Ti e njeh?

- Natyrisht! E kam lexuar para shumë vitesh këtë libër! Të duket e çuditshme?

- Për mua është libër i veçantë dhe e lexoj shpesh. Ishte libri i preferuar i mamasë time. Ajo më vuri emrin e personazhit të librit... Por nuk prisja që një avokat si puna jote, kaq i rëndësishëm dhe kaq i zënë me punë, të kishte lexuar një shkrimtar romantik!

- Njërin gjysh e kisha nga Zaqintho. Dhe ishte pothuajse e domosdoshme të mësoja për Ksenopulon dhe për veprat e tij... Pastaj, kush të tha që unë nuk jam romantik?

- Nuk të njoh akoma..., - tha vajza.

- Por a s'jemi bashkë për këtë arsye? Që të njihemi! Dhe të falënderoj shumë për shpjegimin e bukur, por... e le në mes!

- Po... duhet të ikim... në shtëpi do jenë shqetësuar..., - përsëriti ajo.

- Do ikim menjëherë, por me një kusht! Që shumë shpejt do vijmë përsëri në Akilio, për të vazhduar vizitën!

- Po... kur të duash!

- Nuk do doja të iknim, por do i përshtatem rregullave të shtëpisë tënde! Detyrimisht!

E kapi për dore dhe e drejtoi për nga dalja. Klelias, po në atë moment që buzëqeshte e lumtur, i vinte për të qarë. Dora e saj, e mbrojtur brenda dorës së tij, e bënte të ndihej sikur fluturonte. Në çastin kur ai ia lëshoi dorën për të hyrë në makinë, ajo u ndje fatkeqe.

Kur arritën para shtëpisë së saj, ishte errësuar. Niqifori shoi makinën dhe u kthye nga ajo.

- Klelia, kalova shumë bukur..., - i tha ai ngadalë.

- Edhe unë... Gëzohem që të pëlqeu shëtitja jonë...

- Të gjitha më pëlqejnë, sidomos ti..., - i pëshpëriti dhe dora e tij përkëdheli faqen e saj.

- Je tej mase e bukur..., - vazhdoi ai, - por besoj se nuk jam i pari që po ta them.

- Ndoshta je i pari nga i cili prisja të ma thoshte..., - u përgjigj Klelia dhe zëri po i dridhej lehtë.

Ai lëvizi dhe largoi dorën papritur.

- Thashë ndonjë gjë të keqe? - e pyeti ajo e shqetësuar.

- Jo... Por kjo ndodh sepse po luftoj me veten time që të mos bëj diçka të keqe..., - u përgjigj qetë Niqifori.

- Klelia, je kaq e bukur, por je dhe kaq e vogël...

- Tani e more vesh? - reagoi e prekur ajo.

- Ke të drejtë... por ndonjëherë bëjmë gjëra që nuk duhet t'i bëjmë, vetëm e vetëm se i duam shumë. Edhe unë dua kaq shumë të të njoh... të jem vazhdimisht me ty...

- Edhe unë dua...

E pa dhe toni i tij ishte i çuditshëm. Klelia u ngatërrua. Për një çast mendoi se do e puthte, ndërkohë ai preku lehtë faqen e saj dhe i uroi natën e mirë. Sapo hyri në shtëpi dëgjoi makinën e tij që po largohej. Nuk dinte a do arrinte dot deri në dhomën e saj që të mbyllte derën e të fillonte të qarat.

Evgjenia e priste në këmbë para dritares. Klelia, që hyri me nxitim, duke menduar se kishte shpëtuar nga shpjegimet që duhet të jepte, për një moment u duk e pavendosur, të hynte apo të mos hynte.

- Mos u përgatit të ikësh! - i foli rreptë gruaja. - S'ke nga shkon, këtu është dhoma jote, s'ke ku të shkosh tjetër?

- Diku që të shpëtoj nga dhënia e shpjegimeve, gjë që nuk mund ta përballoj dot në këtë moment! - u përgjigj Klelia me qetësi.

- Atëherë të mbetet vetëm të deziluzionohesh, sepse kudo që të shkosh prej meje nuk do shpëtosh! Të bëra nder se nuk i thashë asgjë babait tënd, por tani do më thuash se ç'ndodhi!

- Evgjeni, asgjë s'ndodhi! Ç'deshe ti të ndodhte? Shkuam në Akilio, e vizituam, dhe meqë u errësua, u kthyem, pa arritur të vizitojmë kopshtet! U kënaqe tani?

- Puna është, a u kënaqe ti?

- Ç'kërkon të marrësh vesh? - e pyeti Klelia dhe u shtri pa qejf në krevat.

- Ajo që dua të marr vesh, është se nëse ai zotëri u soll me të vërtetë si i tillë!

- Pse ç'kujtoje ti? Se do më hidhej përsipër?

- Edhe kjo më shkoi në mendje!

- Atëherë, po të informoj, se përveç dorës nuk më preku asgjë tjetër! Dhe tani, para se të zbrisja nga makina, më përkëdheli faqen! A thua se jam ndonjë vajzë tetë vjeç! - përfundoi ajo e indinjuar.

Evgjenia u zbut dhe u ul pranë saj. E përqafoi me dashuri dhe Klelia u mbështet te supi i saj dhe filloi të qante ngadalë.

- Pusho, zemra ime..., - e përkëdheli ajo. - Qetësohu...

- Evgjeni, doja të më puthte! Jam e dashuruar! Të kujtohet si ndiheshe atëherë kur ishe e re dhe e dashuruar?

- E mbaj mend, zemra ime. Por je akoma e vogël. Pastaj, nuk dimë asgjë për të!

- Të gjithë thonë se është nga avokatët e rinj më të mirë! - nënvizoi Klelia dhe fshiu me inat lotët e saj.

- Avokat i mirë le të jetë për gjyqet, shpirti im! Por ajo që unë dua të marr vesh është, nëse është njeri i mirë apo jo! I mirë dhe i ndershëm!

- Evgjeni, është! Nuk mund të mos jetë dhe zemra ime të rrahë kështu për atë!

- E dashur, pse i ngatërron gjërat? Po të ishte se zemra rrihte vetëm për të mirët, nuk do ekzistonin kaq zemra të plagosura në botë! Më dëgjo edhe mua... Je kaq e padjallëzuar... Kam frikë, Klelia...

- Unë nga e vetmja gjë që kam frikë, është se nëse ai nuk më dashuron!

Kur pas dy ditësh e pa në pragun e shtëpisë së saj, Klelias iu duk sikur ishte në ëndërr.

- Ç'do këtu? - tha e çuditur dhe e trembur.

- Nuk prisja të ma hapje ti derën! - tha dhe ai i surprizuar.

- Qëlloi... Por... përse erdhe në shtëpinë time?

- Dua të takoj babanë tënd për një çështje...

- Dhe unë kujtova se erdhe për mua..., - tha me nerva.

- Po ta dije se ç'luftë bëra me Kavadhian që t'i sillja unë këto letra dhe që ai të mos e kuptonte arsyen e

vërtetë, nuk do kishe këta turinj! - iu përgjigj dhe i buzëqeshi. Tani mund të hyj?

Klelia u mënjanua e turpëruar.

- Më fal! Por kur të pashë, e humba fare!

- Dhe unë, që gjatë gjithë rrugës, pyesja veten nëse do isha me fat që të të shihja, e humba kur ma hape ti derën! Ç'bën? Mirë je?

- Mirë... Po ti?

- Tani që po të shoh jam për bukuri... Por më mungove... Kur do të të shoh?

- Mundesh të shtunën?

- Natyrisht që po! Do të të pres para parlamentit jonik. Si thua?

- Në gjashtë do jem atje...

Në momentin që u shfaq babai i saj, ata me vështirësi i ulën sytë përdhe.

- I dashur, nuk më lajmëruan që keni ardhur! Gëzohem që ju njoha më në fund! Më njoftoi Xhorxhi që duhet t'ju prisja! Kaloni që të bisedojmë!

Babai e shoqëroi Niqiforin në zyrën e tij, dhe para se të mbyllte derën, e porositi Klelian t'u sillte kafe. Donte që t'u shërbente vetë, por nuk kishte siguri te duart e saj që po i dridheshin nga tronditja, prandaj njoftoi kamerieren. U ngjit në dhomën e saj pothuajse duke kërcyer, dhe u ndesh përsëri me Evgjeninë.

- Po, po, po! Ç'është gjithë ky gëzim? - e pyeti gruaja duke e vështuar me dyshim.

- Erdhi, Evgjeni! - tha e gëzuar Klelia dhe e përqafoi fort.

- Kush? O... Shën Spiridhon, vër dorën tënde! E ç'bën këtu?

- Erdhi për të diskutuar një çështje dhe po bisedon me babanë! Evgjëni, do ta takoj të shtunën! Më kërkoi të dalim!

- Dhe këtë lajm po ma thua që të gëzohem!

- Nëse më do, duhet të gëzohesh!

- Ah, shpirti im! Je e gjithë jeta ime, prandaj dhe kam kaq frikë!

Edhe kjo e shtunë vonoi të vinte për Klelian dhe s'kishte ndryshim nga e shtuna e kaluar, përveçse retë e rënduara nuk i kishin qëndruar besnike premtimit të tyre. Binte shi, madje shi i rrëmbyer. Duke u futur nëpër rrugica që të shkurtonte rrugë dhe me çadrën në dorë për t'u mbrojtur nga shiu i rrëmbyer, Klelia arriti para parlamentit jonik fiks në orën gjashtë dhe e gjeti atë atje, duke e pritur.

Hipi në makinën e tij dhe ai i buzëqeshi.

- Shoh që kontesha ime është shumë korrekte!

- Vazhdon të më thërrasësh përsëri konteshë...

- Po... më pëlqen të të quaj kështu... Nuk mund të të mendoj ndryshe...

- Pse mendon për mua?!

- Çdo ditë... Dhe çdo ditë e më shumë...

Për një çast vështrimet u takuan dhe vallëzuan nën tangon e shiut, u rrotulluan si të dehur, por ishte ai i pari që e ndërpreu magjinë. Ndezi makinën dhe pas pak u gjendën jashtë qytetit.

- Ku do shkojmë? - kërkoi të dinte ajo.

- Thashë të shkojmë në Ipso. Nuk do ishte e udhës të na shihnin bashkë në qytet... vetëm nëse nuk do ti ose nëse ke ndonjë propozim tjetër.

- Nuk më intereson se ku shkojmë... Ashtu kot pyeta..., - i tha dhe ai i buzëqeshi.

Shiu sa vinte e shtoej, por Niqifori i jepte makinës me shumë siguri. Pas njëfarë kohe, ndaloi para një kafeneje të qetë, nga të paktat që ishin të hapura në dimër në atë zonë. Hynë brenda me nxitim dhe vunë re se ishin të vetmit. U ulën pranë oxhakut të ndezur dhe porositen çokollatë të ngrohtë.

Klelia e la vështrimin e saj të endej te flakët që kërcenin para saj. Prezenca e tij në krah të saj e trondiste, kishte frikë ta shihte, kishte frikë t'i fliste. E ndiente veten të ngatërruar, nuk dinte se ç'kërkonte prej saj. Donte të qante përsëri... Ç'kishte pësuar vallë? U drithërua kur ndjeu dorën e tij që po përkëdhelte dorën e saj dhe ngriti sytë për ta parë.

- Anglezët kanë një shprehje: “Jap një dhjetëshe për të marrë vesh mendimet e tua”, unë në këtë moment do jepja shumë më tepër për të mësuar se ç'fshihet pas atyre syve që papritur u bënë melankolikë, - i tha ai me të butë.

- Po ja... se si ndihem, ndihem konfuze...

- Për shkakun tim?

- Po... Nga njëra anë nuk të njoh fare, dhe nga ana tjetër më duket sikur kam vite që të njoh. Pse ndodh kjo? Gjithashtu nuk di se ç'mendon ti për mua...

- Në këtë çast, kështu si po të shoh para flakëve, e vetmja gjë që mund të mendoj është se nuk mund të ekzistojë vajzë më e bukur se ty në botë...

Klelia do donte ta vriste kamerierin, i cili zgjodhi atë moment që të vinte e të sillte porosinë, duke prishur magjinë, por të vetmen gjë që mundi të bënte, ishte të ulte sytë e zhgënjyer. Sapo mbetën vetëm, dora e saj instinktivisht u drejtua për te filxhani, por ai e ndaloi. E mori me ngadalë midis pëllëmbëve të tij dhe e afroi

te buzët. Klelia vështroi sytë e tij. Zjarri dërgonte reflekse që kurorëzonin flakën, e cila shihte në thellësi të tyre. Pothuajse besoi se po e ëndërronte puthjen e ëmbël që ai la te buzët e saj. Hapi dhe mbylli qepallat e çuditur, një psherëtimë i doli nga shpirti dhe Niqifori e mori në krahët e tij. Këtë herë puthja e tij ishte e pamundur të ishte lodër e trurit të saj. Ajo depërtoi deri në thellësi të zemrës së saj, e bëri të ndihej grua për herë të parë... Grua e dashuruar, dhe plotësisht e ndërgjegjshme t'i jepej burrit që e mbante në krahë dhe që e puthte derisa t'i merrej fryma... E kishte marrë me vete furia e tij...

Dera që hapej e mbyllej me zhurmë, i ktheu në realitet. Niqifori u tërhoq me lezet. Klelia hapi sytë ngadalë, por shikimi i saj po i bënte lojëra. Hapi e mbylli sytë dhe guxoi ta shihte. Ndeshi në sytë e tij të errësuar dhe uli sytë e saj, por Niqifori e detyroi që ta shihte në sy.

- Klelia, u mërzipte me mua? - i pëshpëriti dhe ajo mohoi me një lëvizje të kokës. - Të tremba? - e pyeti ai përsëri.

- Jo..., - tha vajza ngadalë. - Por nuk e di nëse kjo puthje ka për ty të njëjtin kuptim që ka dhe për mua?

- Për mua tregon se jam i dashuruar... se që ditën e parë që të pashë, këtë puthje e ëndërroja. Dhe në këtë moment, e vetmja gjë që më frikëson, është se mos më thuash që jam i vetëm në këtë që ndiej... Kam frikë se...

- Në dashuri nuk ka vend frika...

- Vetëm kur ka reagim nga partneri, zemra ime...

- Atëherë mos ki frikë..., - e qetësoi ajo duke pëshpëritur.

Niqifori e pa për një çast, para se ta merrte përsëri në krahët e tij, para se ta mbërthente përsëri me një puthje dhe Klelia në thellësi të vetes e dinte se ky mbërthim që ngjante me burgosje do të vazhdonte për gjithë jetën.

Nuk donte të kthehej në shtëpi, nuk donte të dilte nga ajo makinë që ishte mbushur me puthje dhe fjalë të ëmbla dashurie. Qëndronte në krahët e tij duke e shtrënguar fort, me buzët e tij që ngjanin me zogj shtegtarë, që shtegtonin në fytyrën, në gojën dhe qafën e saj, kishte gjithçka që kishte kërkuar për kaq kohë në ëndrrat e saj.

- Nuk dua të iki..., - i pëshpëriste dhe sytë e saj bëheshin përsëri melankolikë.

- As unë. Në këtë moment do të doja ta ndizja makinën dhe të ecja e të mos ndaloja, derisa të gjendeshim të dy diku ku s'kishte shkelur këmbë njeriu! Të të kisha vetëm për vete... Të të merrja në krahët e mi dhe mos të të lija kurrë të ikje prej andej...

- Edhe unë atë dua... por në shtëpi do jenë shqetësuar...

- Po... e di... Evgjenia...

- Në këtë çast do jetë në dhomën time duke qëndruar në këmbë e duke më pritur!

- Kështu bën gjithmonë?

- Që kur të njoha ty...

- I ke folur për mua?

- Po...

- Nga këto pak fjalë që po më thua, nënkuptoj se nuk e aprovon lidhjen tonë?

- Nuk është kjo... Ka frikë... Nuk të njeh...

- Jam dhe i madh në moshë...

- Këtë mos e përsërit më! - u hodh me nxitim Klelia dhe nxitoi ta puthte. - Për mua kjo gjë nuk ka rëndësi!

- Por ka për gjithë të tjerët... Dhe u jap të drejtë...

- Të tjerët nuk mund të kuptojnë atë që ndiej unë...

U largua me shumë mundim nga krahët e tij. Niqifori do shkonte për disa ditë në Athinë për një çështje të zyrës dhe kështu do ta shihte përsëri të shtunën e ardhshme. Hyri në shtëpi pa takuar asnjë, por e dinte se në dhomën e saj dikush e priste, dhe nuk gabonte. Evgjenia, sa e pa të hynte, i hodhi një vështrim nga koka te këmbët.

- U vonove..., - e kritikoi ajo rreptë.

- Po... u harruam...

Evgjenia iu afrua dhe i nguli sytë. Ato që pa nuk i pëlqyen fare dhe ajo mblodhi buzët e zhgënjyer! Por Klelia e përqafoi e lumtur.

- Evgjeni, mos u mërzit me mua! Të paktën jo sot! Jam kaq e lumtur! Më dashuron! E kupton? Ma tha!

- E ç'të tha, domethënë?

- Se është i dashuruar marrëzisht me mua!

- Këtë mund ta besoj..., - u përgjigj qetë gruaja.

Klelia e pa me habi.

- Ç'do të thuash?

- Tjetër gjë është pasioni dhe tjetër gjë dashuria, e dashur. Tjetër gjë është pasioni për një vajzë të bukur dhe tjetër gjë është dashuria e thellë dhe e vërtetë.

- Po ato shkojnë paralelisht! - e kundërshtoi Klelia.

- Jo zemra ime... Nuk shkojnë paralelisht... Jo gjithmonë...

- Pse flet kështu për Niqiforin? Ti nuk e njeh, nuk e ke parë asnjëherë!

- Sepse më flet zemra ime, e dashur. Zemra dhe instinkti... Nuk është për ty ai njeri. Duhej ta kishte menduar se është i madh në moshë dhe të qëndronte larg teje!

- Por, ç'lidhje ka mosha me dashurinë?

- Por, ka me logjikën! E përveç të tjerash, nuk dimë asgjë për të.

- Unë di të vetmen gjë që më intereson! Atë që më dashuron!

- Dhe natyrisht nuk i mjaftoi vetëm të ta thoshte! Donte edhe të ta tregonte!

- Ç'nënkupton me këtë? - e pyeti Klelia e skuqur.

- Duket që kilometra larg që u puthët dhe mos u përpiq të më thuash gënjeshtër!

- Tani po më vë në pozitë të vështirë!

- Më mirë të të vë unë sesa ai! E kupton se ç'dua të them?

- Shumë larg vajte! Vetëm disa të puthura shkëmbyem! Të betohem!

- Të besoj! Por ki kujdes, Klelia! Ki shumë kujdes! Deri kur do i mjaftojnë vetëm disa të puthura nga një vajzë kaq e bukur sa ti?

- Evgjëni... e dashuroj... shumë... Në këtë moment nuk mund të bëj pazare se çfarë do t'i jap nga vetja ime dhe çfarë s'do t'i jap...

- Rëndësi ka të mos i jepesh e tëra, e dashura ime...

Ajo nuk e dëgjoi... Asnjëri nuk mund të dëgjonte. Kënga e dashurisë, me notat e larta të një tangoje, mbulonte çdo akord të butë të logjikës që më kot Evgjenia përpiquej t'i injektonte vajzës së saj të dashur.

Ajo shihte Klelian se si ndryshonte çdo ditë. Vajza po bëhej grua dhe madje e dashuruar e tëra, totalisht. Sapo

ai i bënte një shenjë ajo rendte. Kur kthehej në shtëpi digjej e tëra si zjarr. Kur Niqifori largohej për punë dhe mungonte për disa ditë, vështrimi i dashuruar mbushej me re, buzëqeshja humbiste, nga zemra e saj rridhte gjak. Agapinosi vuri re disa ndryshime, por roli i babait, të cilin e kishte marrë kohët e fundit, nuk e ndihmoi ta diagnostikonte saktë. Evgjenia torturohej ngaqë e vriste ndërgjegjja se po i fshihte të vërtetën, mendime që i shkarkonte te burri i saj bashkë me ankthin se si do përfundonte kjo marrëdhënie, që tashmë po e kuptonte se pak duhej që të arrinte në finalizimin e saj.

Letrat e Pavllos mbërrinin me ritmin e tyre të zakonshëm, dhe shprehnin shumë dashuri, dhe Klelia i përgjigjej letrave të tij me ëmbëlsi, plot ndjenja, por që Pavllon e dëshpëronin. Kur u kthyen prindërit e tij pas festave, Klelia vajti tek Ana për vizitë që të mësonte të rejat nga miku i saj.

- Pavllo është... mirë, - iu përgjigj paraprakisht Ana Llagunari, ndërkohë që i ofroi Klelias një copë kek.

- Është i kënaqur me mësimet e tij? - e pyeti vajza.

- Po... pedagogu i tij është ashtu siç e priste, akoma dhe më i mirë. Bile, Pavllo dha edhe një koncert...

- Vërtet? E si doli?

- Ishte i magjishëm, Klelia! Nëse do kishe mundësi ta shihje! I propozuan një vend në një orkestër të njohur!

- Dhe? Pranoi? - nxitoi të mësonte Klelia.

Por Ana i hodhi një vështrim ngultas.

- Po mendohet... Nga njëra anë i mungon Korfuzi, por nga ana tjetër po i jepet një rast i rrallë...

- Dhe nëse e pranon këtë vend, sa duhet të rrijë në Paris?